



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

UDHËZUES PËR NDËRMJETËSIMIN  
NDËRMJET  
BASHKËMOSHATARËVE NË KONTEKSTIN SHKOLLOR

Prishtinë, 13.10.2023



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të Nenit 44.3 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 01/2021 për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale dhe Nenit 21.5 të Rregullores (QRK) Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar, duke marrë parasysh propozimin e Grupit Punues dhe pas një procesi të bashkëpunimit me partnerët tjerë përkatës vendor dhe ndërkombëtar, nxjerrin këtë:

**UDHËZUES PËR NDËRMJETËSIMIN NDËRMJET  
BASHKËMOSHATARËVE NË KONTEKSTIN SHKOLLOR**

1. Qëllimi i Udhëzuesit për ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor (Udhëzuesi) është nxitja dhe përkrahja e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor në Institucionet e Arsimit Para-Universitar (IAP), në mënyrë që të ndihmojë në:

- 1.1. parandalimin e kryerjes së veprave penale të nxënësve në IAP, veçanërisht të nxënësve/fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale (fëmijëve që nuk i kanë mbushur katërmëdhjetë (14) vjet);
- 1.2. sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe miqësor për të gjithë në IAP dhe për të ju përgjigjur situatave që mund të vijnë deri tek konfliktet ndërmjet bashkëmoshatarëve në shkollë;
- 1.3. sigurimin e ngritjes së vetëdijes të nxënësve për të zgjidhur konfliktet dhe mosmarrëveshjet në mes vete, përmes ndërmjetësimit;
- 1.4. kthimin e raporteve normale në mes të nxënësve dhe re-integrimi i tyre në shkollë dhe shoqëri;
- 1.5. përgatitjen e nxënësve për jetesë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe në miqësi ndërmjet bashkëmoshatarëve në shkollë.

2. Udhëzuesi u drejtohet nxënësve dhe mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave, prindërve, të afërmeve ose personave tjerë, të cilët mund të veprojnë si ndërmjetësues për të zgjidhur konfliktet dhe mosmarrëveshjet midis bashkëmoshatarëve në IAP dhe të cilët hyjnë spontanisht në këtë rol.

3. Udhëzuesi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arbërie NAGAVCI

Ministre e Ministrisë së Arsimit,  
Shkencës, Teknologjisë dhe  
Inovacionit

Albulena HAXHIU

Ministre e Ministrisë së Drejtësisë



Prishtinë, 13 . 10 .2023

## PËRMBAJTJA

Fjalorth i terminologjisë së përdorur në Udhëzues .....	5
HYRJE .....	7
<b>I. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR NDËRMJETËSIMIN NDËRMJET BASHKËMOSHATARËVE NË KONTEKSTIN SHKOLLOR</b> .....	9
1.1. Konfliktet ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor .....	9
1.1.1. Rregullimi i konflikteve të vogla përpara se ato të përshkallëzohen.....	10
1.1.2. Raportimi i konflikteve ndihmon në ndërmjetësimin me të shpejtë dhe me të lehtë ...	11
1.1.3. Qëndrimet që duhet të mbahen nga IAP me nxënësit e konfliktuar.....	12
1.1.4. Rrugët për zgjidhjen e konfliktit.....	12
1.2. Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor .....	14
1.3. Parimet e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor .....	15
1.3.1. Interesi më i mirë i fëmijës.....	16
1.3.2. Shprehja e vullnetit.....	16
1.3.3. Barazia.....	17
1.3.4. E drejta për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet.....	17
1.3.5. Paanshmëria dhe pavarësia.....	18
1.3.6. E drejta e fëmijës për t'u trajtuar me dinjitet dhe ndjeshmëri.....	18
1.3.7. Privatësia dhe konfidencialiteti.....	18
1.4. Pjesëmarrësit në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor.....	19
1.4.1. Nxënësit - palë e përfshirë në procesin e ndërmjetësimit.....	19
1.4.2. Ndërmjetësuesit në kontekstin shkollor.....	19
1.4.3. Edukatori/ja, mësuesi/ja, arsimtari/ja.....	20
1.4.4. Kujdestari/ja i/e klasës.....	20
1.4.5. Kryesia e klasës.....	21
1.4.6. Drejtori i shkollës.....	21
1.4.7. Menaxheri/përgjegjësi i rastit të caktuar nga drejtori.....	21
1.4.8. Këshilli drejtues.....	21
1.4.9. Këshilli i prindërve.....	22
1.4.10. Këshilli i Nxënësve.....	22
1.4.11. Shërbimet tjera profesionale dhe mbështetëse.....	22
1.5. Ndërmjetësimi “nga, për, me dhe ndërmjet të nxënësve/fëmijëve”.....	22
1.6. Detyrat e ndërmjetësuesve .....	23
1.7. Përparësitë/Ndikimet e ndërmjetësimit .....	24
<b>II. FAZAT E PROCESIT TË NDËRMJETËSIMIT NDËRMJET BASHKËMOSHATARËVE NË KONTEKSTIN SHKOLLOR</b> .....	25
2.1. Inicimi i procesit të ndërmjetësimit - Referimi në ndërmjetësim .....	25
2.2. Pajtimi i palëve për zhvillimin e ndërmjetësimit.....	25
2.3. Takimet e ndërmjetësimit .....	26
2.4. Marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit .....	27
2.5. Ndërprerja dhe përfundimi i procesit të ndërmjetësimit .....	28

<b>III. AFTËSIMI PROFESIONAL DHE PROMOVIMI I NDËRMJETËSIMIT NDËRMJET BASHKËMOSHATARËVE NË KONTEKSTIN SHKOLLOR</b> .....	29
3.1. Aftësimi për ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor.....	29
3.1.1. Përzgjedhja e nxënësve si ndërmjetësues.....	29
3.1.2. Përgatitja dhe ngritja e kapaciteteve për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve.....	30
3.1.3. Emërimi dhe certifikimi i nxënësve për ndërmjetësim.....	31
3.2. Promovimi i ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor.....	31
Shtojca 1: Dhjetë (10) parimet në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor.....	33
Shtojca 2: Deklarata nën betim e ndërmjetësuesit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor	34
Shtojca 3: Forma standarde e raportit të ndërmjetësimit .....	35
Shtojca 4: Forma e Marrëveshjes e arritur në ndërmjetësim ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor.....	36
<b>LISTA E BURIMEVE</b> .....	37

## Fjalorth i terminologjisë së përdorur në Udhëzues

- **Dhunë** - përfshin por nuk kufizohet në veprat apo veprimet e qëllimshme që i bëjnë një nxënës nxënësit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton apo kanos dhembjen fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; vënia e nxënësit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike, si dhe të gjitha llojet e dhunës të përcaktuara në Rregulloren për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës dhe legjislacionin në fuqi;
- **Drejtjori** - drejtuesi më i lartë i një IAP;
- **Fëmijë** - nënkupton çdo nxënës të IAP nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet;
- **Hapësira në selinë dhe jashtë selisë së institucionit** - nënkupton hapësirën brenda dhe jashtë shkollës gjegjësisht IAP, ku zhvillohet puna edukativo arsimore, si dhe aktivitetet e tjera jashtëshkollore;
- **Institucion i arsimit parauniversitar/IAP** - nënkupton çdo institucion shkollor ose aftësues që ofron shërbime arsimore të nivele 0 - arsimit parashkollor, 1 - arsimit fillor, 2 - arsimit mesëm i ulët, 3 - arsimit mesëm i lartë dhe 4 arsimit postsekondar;
- **Kodi i drejtësisë për të mitur/Kodi** - Kodi nr. 06/L-006 i drejtësisë për të mitur; (Gazeta Zyrtare, nr. 17, 18 tetor 2018);
- **Konventa mbi të drejtat e fëmijës/Konventa** - Konventa mbi të drejtat e fëmijës e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989;
- **Kushtetutë** - Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- **Ligji për arsimin parauniversitar** - Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 17, 16 shtator 2011);
- **Ligji për mbrojtjen e fëmijës** - Ligji Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës; (Gazeta Zyrtare nr. 14, 17 korrik 2019);
- **Ligji për ndërmjetësim** - Ligji nr. 06/L-009 për ndërmjetësim (Gazeta Zyrtare nr. 14, 20 gusht 2018);
- **Mbrojtja e fëmijës** - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, qoftë në hapësira në selinë dhe jashtë selisë së IAP;
- **Mësimdhënës** - personi i kualifikuar sipas dispozitave të Ligjit për arsimin parauniversitar me përgatitje akademike dhe profesionale, i punësuar për ofrimin e shërbimeve arsimore për nxënësit në IAP, që përfshijnë por nuk kufizohen në: Edukatori/ja, mësuesi/ja, arsimtari/ja;

- **Ndërmjetësim** - nëse konteksti nuk kupton ndryshe, nënkupton procedurën procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor;
- **Ndërmjetësuesi** - nëse konteksti nuk kupton ndryshe, një palë e tretë e paanshme dhe e pavarur, që mund të jetë nxënës, mësimdhënës, drejtor, prindër ose i afërm, i/e cili/a ndihmon fëmijët të përmirësojnë një marrëdhënie ose të zgjidhin një konflikt mes tyre;
- **Në të gjitha fazat** - përfshin të gjitha procedurat në të cilat fëmija është në kontakt me institucionet përkatëse apo me profesionistët për mbrojtjen e fëmijës;
- **Nxënës** - çdo fëmijë i regjistruar në çfarëdo IAP;
- **Prind** - nënkupton personin/personat që e kanë lindur ose e kanë adoptuar fëmijën, të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar, apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese;
- **Qendra për Punë Sociale/QPS** - është institucion publik profesional i nivelit komunal, kompetente për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale;
- **Regjistri i rasteve të dhunës në IAP** - nënkupton bazën e të dhënave në të cilën regjistrohen rastet e raportuara të dhunës në IAP, që mbahet sipas Rregullores për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës;
- **Rregullore për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës** - Rregullore (QRK) Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar (20.09.2013);
- **Rrjeti i brendshëm mbrojtës:** Edukimi parashkollor – (Drejtori i Institucionit, Këshilli i Prindërve) dhe Shkollat (Drejtori i shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli Drejtues i Shkollës dhe Këshilli i Nxënësve);
- **Rrjeti i jashtëm mbrojtës:** Ministria përkatëse për arsim - (Sektorët e Inspektimit të Arsimit në Rajon), Këshilli i Prindërve të Kosovës, Këshilli i Nxënësve në nivel nacional), Drejtoria përkatëse Komunale e Arsimit- (Këshilli i Nxënësve dhe Këshilli i Prindërve në nivel komunal, Zyrtari përkatës për të Drejtat e Fëmijës), Drejtoria përkatëse për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - (Qendra për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, Ministria e Drejtësisë - (Shërbimi Sprovues i Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Policia e Kosovës si dhe Mekanizmat tjerë ndihmës - (Mediat, Institucioni i Avokatit të Popullit, organizatat joqeveritare që punojnë për të drejtat e fëmijëve dhe çështjet e dhunës në shkollë);
- **Shkollë** - çdo IAP.
- **Udhëzim Administrativ për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale** - Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 01/2021 për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale (19.01.2021)

## HYRJE

*Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre...Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.*

*(Kushtetuta, Neni 50 (1 dhe 3))*

Me miratimin e Udhëzimit Administrativ (QRK)-nr. 01/2021 për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale (Në tekstin e mëtejshëm: Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 01/2021), në janar të vitit 2021, është bërë progres në përmirësimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve. Një nga çështjet e rëndësishme, është edhe përfshirja e Ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, me ç'rast në paragrafin 3 të Nenit 44 (Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor) të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 01/2021 përcaktohet si në vijim:

*“Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për arsim dhe partnerët tjerë përkatës vendor dhe ndërkombëtar duhet të nxisin dhe përkrahin ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve, dhe nxjerr udhëzues përkatës për këtë proces.”*

Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, është parashikuar edhe në paragrafin 5 të Nenit 25 (Procedura e zgjidhjes së rastit të dhunës në shkollë) të Rregullores (QRK) Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar, në të cilin përcaktohet:

*“Institucioni i arsimit para-universitar në bashkëpunim me institucionet tjera qeveritare dhe jo qeveritare krijon mekanizmin e ndërmjetësimit jo formal ndërmjet bashkë-moshatarëve si metodë për zgjidhjen e konfliktit të shkaktuar si rezultat i dhunës.”*

Si rrjedhojë, bazuar në Nenin 44 (paragrafi 3) të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 01/2021 dhe Nenin 25 (paragrafi 5) të Rregullores (QRK) Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe partnerët përkatës vendor dhe ndërkombëtar kanë përgatitur Udhëzuesin për ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor (Udhëzuesi), me qëllim që të nxisin dhe përkrahin ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve në institucionet e arsimit para-universitar (IAP), si metodë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve të shkaktuar si rezultat i dhunës, si dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale nga nxënësit, veçanërisht të nxënësve/fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale (fëmijëve që nuk i kanë mbushur katërmbëdhjetë (14) vjet).

Megjithëse, ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, është më pak formal, megjithatë duhet pasur parasysh që në këtë proces janë të përfshirë nxënësit dhe si rrjedhojë edhe për të gjitha proceset tjera ku janë të përfshirë nxënësit, duke përfshirë edhe ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, të gjitha veprimet dhe vendimet që ndërmerren me dhe për fëmijën duhet të jenë në pajtim me legjislacionin në fuqi, që përfshinë por nuk kufizohet me: Kushtetutën, Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Ligjin për ndërmjetësim, Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale, Rregulloren për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës dhe legjislacionit përkatës në fuqi. Si rrjedhojë të gjitha çështjet e sugjeruara në këtë udhëzues janë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Duke u nisur nga fakti që sipas Kushtetutës, “*Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë*” (Neni 47.1) dhe po ashtu sipas Kushtetutës, “*Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi*” (Neni 50.3) dhe duke marrë parasysh që Ligji për arsimin parauniversitar (Neni 1 (2.5)) përcakton që një nga qëllimet e arsimit dhe aftësisë parauniversitar është edhe përgatitja e nxënësit për jetesë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe në miqësi me pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, e më gjerë, si rrjedhojë e drejta për arsim dhe mbrojtja e fëmijës janë përgjegjësi të shtetit. Prandaj, ky Udhëzues ka për qëllim që të përkrah IAP dhe personat përkatës, me këshilla dhe udhëzime konkrete për zgjidhjen paqësore të konflikteve përmes ndërmjetësimit, për të krijuar një ambient të sigurt, jo-abuzues, atraktiv dhe stimulues që siguron mirëqenie për nxënësit.

Ky udhëzues ka tri komponente kryesore:

- (1) Ndërtimi i kapaciteteve të IAP për t’u marrë me ndërmjetësim në një mënyrë të përshtatshme;
- (2) Aftësimi i nxënësve, mësuesve, prindërve dhe personave tjerë për të zgjidhur në mënyrë paqësore mosmarrëveshjet dhe konfliktet e nxënësve në IAP;
- (3) Ngritjen e vetëdijes në IAP që përmes aktiviteteve të ndryshme të rrisin ndjeshmërinë e zgjidhjes së konflikteve, parandalimit të thellimit të konflikteve dhe krijimit të ambienteve të pasigurta në shkolla si dhe parandalimit të kryerjes së veprave penale nga fëmijët që janë nxënës në IAP.

Ky Udhëzues është hartuar edhe duke marrë parasysh praktikatat e mira të deritanishme që janë zhvilluar në Kosovë<sup>1</sup> si dhe standardet dhe praktikatat përkatëse ndërkombëtare, gjithnjë duke marrë parasysh që këto praktika të përshtaten me kushtet dhe kontekstin e Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi në Kosovë.

Duke marrë parasysh bashkëpunimin dhe përkrahjen që kemi pasur gjatë hartimit të këtij udhëzuesi, shfrytëzojmë rastin që të falënderojmë Terre des hommes Kosova (TdHK) si dhe të gjithë ata/ato që kanë kontribuar në hartimin dhe finalizimin e këtij udhëzuesi.

Shpresojmë që ky udhëzues do të kontribuojë sado pak që të lehtësohet procesi i ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor.

<sup>1</sup> Ky udhëzues përmban materiale edhe nga Doracaku i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konflikteve mes Bashkëmoshatarëve në Shkolla, (KEC dhe ForumZFD) dhe nga Doracaku për Ekipet ndërmjetësuese mes bashkëmoshatarëve (KEC).

# I. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR NDËRMJETËSIMIN NDËRMJET BASHKËMOSHATARËVE NË KONTEKSTIN SHKOLLOR

## 1.1. *Konfliktet ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor*

Konflikti mund të përkufizohet si situatë në të cilën individët nuk pajtohen apo kanë nevoja, interesa apo vlera të ndryshme të cilat rezultojnë në tensione në mes tyre.<sup>2</sup> Më konkretisht “konflikti është fakti, ajo që ndodh dhe që nuk perceptohet njësoj nga të dyja palët,”<sup>3</sup> pra “nënkupton një shoqëri me tensione, me përçarje dhe të përfshirë në veprime të dhunshme. I parë në një perspektivë të tillë, konflikti trajtohet si një fenomen negativ e që duhet shmangur.”<sup>4</sup> Konflikti është pjesë e të gjitha sferave të jetës shoqërore dhe ekziston edhe në shkolla. Sikurse që në çdo marrëdhënie dhe bashkëveprim të njerëzve ballafaqohen me situatë dhe me moment e me konflikte dhe mosmarrëveshje të llojeve të ndryshme, ashtu “Edhe në mesin e fëmijëve në veçanti moshat shkollore ballafaqohen me situata ku lindin mospajtime, kundërshtime dhe si pasojë vijnë deri tek konfliktet, të cilat sjellin probleme të ndryshme në mes bashkëmoshatarëve por edhe familjeve të tyre dhe mbarë shoqërisë.”<sup>5</sup>

IAP duhet të jenë një vend socializimi, një model integrimi dhe një vend për zgjidhjen e konflikteve dhe në vazhdimësi të ndërmarrin hapa në parandalimin e çfarëdo konflikti brenda shkolle apo jashtë saj kur nxënësit janë të përfshirë. Konfliktet ndërmjet nxënësve, qoftë në hapësira në selinë dhe jashtë selisë së IAP mund të sjellin dhunë. “Edhe pse mësimdhënësit kanë rol thelbësor në parandalimin e dhunës në IAP, ata/ato nuk mund ta ndalojnë dhunën të vetëm. Ngase shkaqet e paraqitjes së dhunës në IAP janë shumë faktoriale, prandaj për të parandaluar dhunën kërkohet angazhim dhe qasje shumë dimensionale e të gjithë akterëve, përfshirë rjetin e brendshëm dhe të jashtëm mbrojtës.<sup>6</sup> Po ashtu, është shumë e rëndësishme që shumë prej këtyre konflikteve në shkolla mund dhe duhet të zgjidhen në mënyrë paqësore, mund të zgjidhen edhe përmes ndërmjetësimit. Në këtë drejtim, IAP përveç që duhet të marrin të gjitha masat e përshtatshme për mbrojtjen e nxënësve nga çdo formë e dhunës, duhet të ndërmarrin edhe procedura efektive të parandalimit dhe identifikimit, raportimit, referimit, trajtimit duke përfshirë edhe procesin e ndërmjetësimit.

Cilado qoftë formë e dhunës së një nxënësi nga nxënësi tjetër, mund të ketë pasoja në jetën dhe mirëqenien e nxënësve në aspektin fizik, emocional dhe të ndërtimit të marrëdhënieve të tyre. Prandaj është shumë e rëndësishme që në çdo IAP nuk duhet lënë nxënësit të përballen të vetëm me konfliktin. Duhet marrë masa dhe veprime që nxënësi jo vetëm të ndjehet i lirë të raportojë por edhe të ketë përkrahjen dhe bashkëpunimin e të gjithë akterëve, përfshirë rjetin e brendshëm dhe të jashtëm mbrojtës dhe të mësohen nxënësit si të mbrohen dhe çfarë të bëjnë në rastet kur ata përballen me konflikte, qoftë në hapësira në selinë dhe jashtë selisë së IAP.

2 Shih Manual trajnimit: Ligji për ndërmjetësimin - USAID Prill 2012, f. 15

3 Shih Hajrullah Mustafa: Ndërmjetësimi në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe efektshmëria pozitive e tij, *Opinio Juris*, Nr. 1/2015, f. 87

4 Doracak për Ekípet ndërmjetësuese mes bashkëmoshatarëve, KEC, fq. 14. Po këtu, fq. 30:

5 Doracak i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konflikteve mes Bashkëmoshatarëve në Shkolla, Prishtinë, Qendra për Arsimit e Kosovës (KEC) dhe ForumZFD, Maj 2019, fq.8.

6 Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar, Fq.5

IAP duhet të krijojnë kulturën dhe sistemin që të inkurajojnë nxënësit që të ndihmojnë njëri tjetrin, të denoncojnë sjelljet e këqija dhe njëkohësisht të mbrojnë nxënësit që ndodhën në një situatë të konfliktit.<sup>7</sup>

Parandalimi i çfarëdo konflikti brenda shkollës apo jashtë saj, kur nxënësit janë të përfshirë, është obligim ligjor i të gjithë personave të punësuar në institucione arsimore, të cilët duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm që të sigurojnë se nxënësit dhe punonjësit nuk lëndohen apo u ekspozohen fjalëve dhe veprimeve fyese.<sup>8</sup> Mbrojtja dhe siguria e nxënësve duhet të jetë prioritet për secilin IAP dhe duhet të jetë në thelb të të gjitha proceseve dhe aktiviteteve të shkollës. IAP janë të obliguara të sigurojnë mekanizma që të mbrojnë nxënësit nga çfarëdo lloj dhune, përjashtimi social apo pasigurie që do ta dëmtonte mirëqenien e nxënësve.

Mjedisi miqësor, i sigurt, i pa-dhunshëm dhe jo diskriminues nënkupton krijimin e klimës pozitive në shkollë që kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin fizik, social, emocional për të gjithë nxënësit. Për më tepër klima pozitive shkollore mund të çojë në ulje të mungesave, të shërbejë si një metodë e parandalimit të dukurive negative, të minimizojë rastet e dhunës, dhe si rrjedhojë nxënësit arrijnë rezultate më të mëdha akademike.<sup>9</sup>

Duhet pasur parasysh që ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor nuk është një mjet i vetëm për të zgjidhur konfliktet në shkollë, por është një mjet i cili u mundëson nxënësve të ndërgjegjësohen se është e mundur të jetojnë më mirë së bashku dhe se një konflikt mund të zgjidhet në mënyrë paqësore. Njëkohësisht, ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, është një mjet për parandalimin e kryerjes se veprave penale nga nxënës në IAP.

Të kundërshtosh, refuzosh përdorimin e dhunës është me tepër se trimëri. Sjellja e kundërt ndihmon në riciklimin e saj. Njerëzit, që zgjedhin sjelljen e parë janë të shumtë.<sup>10</sup>

### *1.1.1. Rregullimi i konflikteve të vogla... përpara se ato të përshkallëzohen*

Gjatë procesit të ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor duhet kushtuar rëndësi "konflikteve të vogla", konflikteve që nuk janë shumë të dukshme ose "në dukje të parëndësishme". Ideja është që të parandalohen dhe rregullohen të gjitha këto konflikte të vogla duke zgjidhur tensionet dhe duke kërkuar zgjidhje konstruktive, një marrëveshje të favorshme. Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor mund të parandalojë përshkallëzimin e konflikteve, ideja është që të zbutet ajo që mund të shkaktojë ortek nga një topë bore. Është, po ashtu, një mjet parandalimi të kryerjes se veprave penale nga nxënës në IAP, dhe një mjet për të përmirësuar klimën e shkollës në terma afatgjatë, gjegjësisht është trajtim i dhunës në burim. Në vend që të luftohet kundër dhunës a posteriori, ndërmjetësimi në konfliktet e vogla bën të mundur trajtimin e tij në burim, duke përmirësuar

<sup>7</sup> Shih Doracak i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konflikteve mes Bashkëmoshatarëve në Shkollë, Prishtinë, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe ForumZFD, Maj 2019, fq.8.

<sup>8</sup> Shih Neni 4, Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 17, 16 shtator 2011)

<sup>9</sup> Shih Udhëzues i shkurtër- Shndërrimi i shkollave në mjedise miqësore dhe jo abuzuese për fëmijët, Tetor 2020, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

<sup>10</sup> Shih Doracak për Ekipe të ndërmjetësueses mes bashkëmoshatarëve, KEC, fq. 23

atmosferën midis nxënësve: Gjithnjë duhet pasur parasysh që nëse nxënësit mësohen të zgjidhin konfliktet në mënyrë paqësore do të jenë dashamirës mes tyre.

Parandalimi i përshkallëzimit të konflikteve tek nxënësit është shumë e rëndësishme sepse “Me thellimin e konfliktit ekziston mundësia dhe rreziku i shkallëzimit të tij të mëtejshëm dukë e bërë të pamundur mundësinë e dialogut, të komunikimit e për rrjedhojë dhe të zgjidhjes së konfliktit.”<sup>11</sup>

Konflikti nuk është statik, por është një proces dinamik që përfshin spiralen e shkallëzimit dhe të deshkalëzimit. Konflikti nuk mund të eliminohet ose injorohet, por duhet të gjenden e përpunohen rrugë për njohjen e trajtimin e konfliktit, si rrjedhojë ndërmjetësimi sa më i hershëm në konfliktet në mes të nxënësve ndihmon jo vetëm që konflikti të zgjidhet më lehtë por edhe pasojat e konflikteve të jenë më të vogla. Si rezultat parandalon dhunën dhe kryerjen e veprave penale nga nxënësit.

#### **Një klasë jotolerante, ku sundon:**

- ✓ formimi i grupacioneve, klikave dhe grupeve rebele,
- ✓ intoleranca ndaj dallimeve raciale e kulturore,
- ✓ mospërkrahja e shokëve të klasës që qon në vetmi dhe izolim,
- ✓ zemërimi për arritjet e të tjerëve,

**...është terren pjellor për krijimin e armiqësive, mosbesimit dhe konflikteve.<sup>12</sup>**

#### ***1.1.2. Raportimi i konflikteve ndihmon në ndërmjetësimin më të shpejtë dhe më të lehtë***

Shkolla duhet të promovojë dhe duhet të krijojë sistem dhe kulturë të raportimit të konflikteve dhe dhunës ndërmjet nxënësve. Çdo nxënës, mësues, drejtor, prind dhe punonjës tjetër në IAP që dyshon ose që dinë që ka pasur konflikt apo dhunë ndaj nxënësit/ës, obligohen që menjëherë ta raportojnë rastin. Të gjitha rastet e dhunës dhe konflikteve të paraqitura në IAP duhet të shqyrtohen menjëherë nga drejtori dhe mësuesit. Drejtori është obliguar të sigurojë, ruajë dhe të analizojë të dhënat mbi dhunën e paraqitur në IAP që drejton, në mënyrën më të mirë të mundshme. Regjistri i rasteve të dhunës në IAP mbahet sipas udhëzimeve nga Sistemi i Menaxhimit të informatave në Arsim, duke iu referuar Udhëzuesit për zbatim të Protokollit për Parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para universitar (Rregullore QRK-21/2013).

<sup>11</sup> Doracak për Ekipe të ndërmjetësuese mes bashkëmoshatarëve, KEC, fq. 14.

<sup>12</sup> Po aty, fq. 22

### 1.1.3. Qëndrimet që duhet të mbahen nga IAP me nxënësit e konfliktuar

Llojet e qëndrimeve që duhet të mbahen nga IAP me nxënësit e konfliktuar janë:

- ✓ **Qëndrimi që synon zgjidhjen e problemit** - Konflikti është në të njëjtën kohë një problem që kërkon zgjidhje. Pra, sa herë që lind një konflikt në hapësirën e selisë dhe jashtë selisë së IAP, mësimit duhet të përpiqen ta zgjidhin atë së bashku me të gjithë nxënësit dhe jo t'i përjashtojë ata nga zgjidhja e tij. Kjo jo vetëm do të sillte ide të shumta, por edhe do të forconte klimën dhe marrëdhëniet pozitive në IAP.
- ✓ **Qëndrimi që synon arritjen e kompromisit** - Ky qëndrim kërkon t'u bëjë të ditur nxënësve se në jetë është e vështirë të arrish gjithmonë dhe gjithçka që dëshiron. Për këtë arsye, shpesh është mirë që palët në konflikt të arrijnë një kompromis ndërmjet tyre dhe ta vlerësojnë kompromisin si arritje. Kjo kërkon nga mësimit që jo vetëm të dëgjojë mirë kërkesat e nxënësve, por edhe t'i mundësojë ata të dëgjojnë dhe të kuptojnë mirë kërkesat e njëri-tjetrit.
- ✓ **Qëndrimi që synon krijimin e situatave paqësore në klasë dhe IAP** - Zakonisht për mësimit duhet që prirjen drejt situatave të tilla, pjesa më e madhe e konflikteve të fëmijëve janë të parëndësishme dhe ata përpiqen që të drejtojnë vëmendjen e nxënësve drejt gjërave të tjera.
- ✓ **Qëndrimi shpërfillës** - Një qëndrim i tillë bazohet në idenë se është me mirë që nxënësit të mësohen të parashikojnë dhe të gjykojnë vetë pasojat e veprimeve të tyre. Për këtë arsye, mësimit duhet të lejon nxënësit të punojnë vetë, pasi u ka përcaktuar më parë kufijtë e këtij veprimi.<sup>13</sup>

### 1.1.4. Rrugët për zgjidhjen e konfliktit

Rrugët për zgjidhjen e konflikteve mund të jenë të ndryshme dhe në varësi të situatave dhe konflikteve konkrete. Megjithatë, një ndër rrugët që sugjerohet të ndiqet në rastet e zgjidhjes së konflikteve në mënyrë paqësore përmban hapat e mëposhtëm:

- ✓ **Hapi i parë** synon të ndihmojë nxënësit e konfliktuar të artikulojnë më mirë kërkesat e tyre. Në këtë rast mund të bëhen pyetje, që i ndihmojnë nxënësit e konfliktuar t'i shprehin kërkesat e tyre lidhur me konfliktin konkret.
- ✓ **Hapi i dytë** synon të zbulojë shkaqet e konfliktit dhe të ndihmojë nxënësit të përcaktojnë më mirë lidhjen e tyre në konflikt. Meqë shpeshherë konfliktet kanë si shkak perceptimet e gabuara të nxënësve lidhur me atë që kërkojnë, ky hap mundëson sqarimin e mëtejshëm të tyre.
- ✓ **Hapi i tretë** synon të shqyrtojë mundësitë që ofrohen për të kënaqur nxënësit e konfliktuar. Këtu mund të bëhen pyetje të tilla si: Cilat janë disa nga rrugët për të plotësuar dëshirat tona? Cilat janë disa nga rrugët që edhe ana tjetër të mund t'i plotësojnë dëshirat e saj? Çfarë sugjerojnë shokët/et e tjerë të klasës në këtë drejtim?
- ✓ **Hapi i katërt** synon shqyrtimin e alternativave të zgjidhjeve. Pyetjet që mund të bëhen për këtë qëllim mund të jenë: Cila prej rrugëve të propozuara është më e mira? Cilat do

<sup>13</sup> Shih, Doracak për Elipet ndërmjetësuese mes bashkëmohatarëve. KEC, fq. 14

- ✓ të ishin pasojat e saj për nxënësit e konfliktuar? A do të jenë të gjithë të kënaqur prej tyre?
- ✓ **Hapi i pestë** synon zgjedhjen me të mirë për nxënësit e konfliktuar. Përveç kësaj, në këtë fazë mund t'u kërkohet atyre që jo vetëm ta miratonin atë, por edhe të shprehnin përgjegjësinë e tyre për pasojat e saj.
- ✓ **Hapi i gjashtë** synon të fillojë procesin e shqyrtimit të vlerës praktike të zgjidhjes së pranuar dhe të jetëgjatësisë së saj.<sup>14</sup>

Hapat e mësipërm, do të ndihmojnë mësimdhënësit dhe ndërmjetësuesit që të arrijnë më shpejt në thelbin e konfliktit dhe ne gjetjen e zgjidhjeve të tij, si rrjedhojë edhe në arritjen e zgjidhjes përmes ndërmjetësimit.

Më poshtë, po ju kujtojmë disa këshilla të thjeshta, që i sugjeron praktika e gjatë e trajtimit dhe e zgjidhjes së konflikteve, e që duhet pasur parasysh edhe në procesin e ndërmjetësimit dhe për të filluar procesin e ndërmjetësimit.

- ✓ Koha më e mirë për t'u marrë me një konflikt është kur nxënësit e përfshirë në të janë relativisht me të qetë. Nisja e një beteje fizike do të thellonte konfliktin;
- ✓ Mos harroni se edhe njerëzit, që kërcënojnë ose sulmojnë të tjerët kanë pikat e tyre të dobëta, edhe ata kanë frikë. Përpara se të veproni, përpiquni t'i njihni dhe t'i kuptoni ata;
- ✓ Përpiquni sa më shumë të jetë e mundur të kuptoni se cilat janë motivet, që i kanë shtyrë bashkëmoshatarët në një grindje, çfarë shpresojnë të arrijnë, duke u përfshirë në të dhe cila është frika që i shoqëron;
- ✓ Mos i pranoni sjelljet e dhunshme, por mos harroni edhe bashkëmoshatarët, që i ushtrojnë ato janë qenje njerëzore. Përpiquni të zbuloni elementet pozitive të personat e tillë, pasi kjo mund t'ju ndihmojë të ndikoni në ndryshimin e tyre;
- ✓ Mos harroni, ne kemi mundësi të bëjmë edhe mirë edhe keq. Shanset për të bërë mirë nuk mungojnë. Kjo varet vetëm nga vendimi që marrim;
- ✓ Fantazia është dhuntia jonë e madhe. Ajo duhet shfrytëzuar për të shqyrtuar sa më shumë alternativa përfundimesh pozitive për konfliktet. Kjo do të ndihmojë edhe procesin e zgjedhjes së alternativës më të mirë dhe përfundimit me sukses të ndërmjetësimit;
- ✓ Respekti është shumë i rëndësishëm në marrëdhëniet shoqërore. Nëse i respektojmë të tjerët, edhe ata do të priren të na respektojnë ne. Ne do të jemi më të aftë të respektojmë të tjerët, nëse mësojmë të respektojmë vetveten;
- ✓ Kur nga zgjidhja e një debati të dyja palët janë të kënaqura me përfundimin, atëherë kemi të bëjmë me ne zgjidhje fituesish. Vetëm respekti dhe vlerësimet pozitive për përfundimet e mundshme të konfliktit mund të çojnë në zgjidhje të tilla;
- ✓ Përpiquni të kuptoni dhe të vlerësoni problemin nga të gjitha këndvështrimet e mundshme. Kjo do t'ju ndihmojë të njihni në plotësi tablonë e konfliktit dhe të siguronit zgjidhje fituesish.<sup>15</sup>

<sup>14</sup> Shih, Doracak për Ekipe të ndërmjetësuese mes bashkëmoshatarëve, KEC, fq. 25

<sup>15</sup> Shih, Po aty, fq. 23

## 1.2. Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor

Në Republikën e Kosovës, Ligji për Ndërmjetësim, ndërmjetësimin e përkufizon si një veprimtari jashtëgjyqësore, pra është metodë alternative për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet subjekteve të së drejtës, e cila zhvillohet në mënyrë të pavarur nga sistemi gjyqësor.<sup>16</sup> Kjo procedurë është tërësisht vullnetare si nga pikëpamja e përzgjedhjes së saj, si alternativë për zgjidhjen e konfliktit, në zgjedhjen e ndërmjetësuesit/es dhe deri në pranimin ose jo të marrëveshjes së propozuar. Ndërsa, Ndërmjetësues është personi i tretë dhe neutral, i/e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i/e autorizuar për të ndërmjetësuar në mes të dy apo me shumë palëve që synojnë zgjidhjen e kontesteve, në përputhje me Ligjin për Ndërmjetësim, parimet, rregullat dhe procedurat e ndërmjetësimit.<sup>17</sup>

Përveç ndërmjetësimit sipas Ligjit për Ndërmjetësim, një lloj i veçantë i ndërmjetësimit është edhe Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve, i cili dallon ndërmjetësimi sipas Ligjit për Ndërmjetësim dhe nga Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor. Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve është një proces më pak formal në të cilin për palët e përfshira në kontest, fëmijën kryes i veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale dhe bashkëmoshatarin e tij në cilësinë e palës së dëmtuar, përzgjidhet një ose më shumë ndërmjetësues për t'iu ndihmuar në arritjen e një zgjidhje të kënaqshme për të dyja palët dhe për të zgjidhur konfliktin. Qëllimi i ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve është dhënia e mundësisë së kthimit të raporteve normale në mes të bashkëmoshatarëve dhe rehabilitimit të fëmijës dhe re-integrimi i tij në shoqëri. Procedura për ndërmjetësim ndërmjet bashkëmoshatarëve zhvillohet sipas parimeve të përcaktuara në Kodin e drejtësisë për të mitur dhe në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat Ligjit për ndërmjetësim dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji si dhe Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 01/2021 për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale. Në Ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve, Prokurori i shtetit për të mitur apo menaxheri i rastit, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe historinë e fëmijës, nëse vlerëson se do të jetë më e përshtatshme dhe në interesin më të mirë të fëmijës mund të propozoj procedurën për ndërmjetësim. Ndërmjetësues në këtë lloj të ndërmjetësimit janë Ndërmjetësuesit për të mitur të cilët janë të licencuar nga Ministria e Drejtësisë.<sup>18</sup>

Ndërsa, Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, është një proces i zgjidhjes së konflikteve në jetën e përditshme në IAP, në të cilin një palë e tretë e paanshme dhe e pavarur, që mund të jetë nxënës, mësues, kujdestarë, drejtor, prindër ose i afërm, përpiket, nëpërmjet organizimit të takimeve ndërmjet nxënësve, t'i ndihmojë ata të përmirësojnë një marrëdhënie ose të zgjidhin një konflikt mes tyre. Veçantia e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor është që në këtë proces ndërmjetësuesit hyjnë

<sup>16</sup> Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 3 (1.1)

<sup>17</sup> Shih Neni 22 Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësimin i cili përcakton kushtet për ndërmjetësuesit si dhe procesin e certifikimit dhe licencimit të tyre; Udhëzimin Administrativ (MD) Nr. 03/2019 për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës dhe Neni 3 (1.2), Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës.

<sup>18</sup> Shih Kapitulli II- Ndërmjetësimi (nenet 9-11) Kodi nr. 06/L-006 i drejtësisë për të mitur (Gazeta Zyrtare, nr. 17, 18 tetor 2018), Kapitulli VI – Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve (Nenet 37-44), Udhëzim Administrativ (QRK) nr. 01/2021 për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale (19 janar 2021); Kreu III - Referimi i rasteve të të miturve në procedurë të ndërmjetësimit (Nenet 18-25), Rregullore e Këshillit Prokurorial të Kosovës Nr.04/2019 për procedurën e ndërmjetësimit të rasteve nga prokuroria

spontanisht në këtë rol, pra secili mund të luajë këtë rol. Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor është një formë edukimi të nxënësve dhe punonjësve të IAP si dhe në përvetësimin e një kulture dialogu dhe tolerance, është një kulturë e bazuar në komunikim, pranimin e dallimeve të tjetrit dhe sa më herët të mësohen nxënësit me të, aq më shumë burime do të kenë për të menaxhuar konfliktet gjatë gjithë jetës së tyre të ardhshme. Duke mësuar të zgjidhin konfliktet përveç dhunës, por përmes dialogut, nxënësit zhvillojnë aftësi psikosociale të afta për të ndryshuar klimën e shkollës. Duhet vënë në dukje se ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor nuk bëhet fjalë për një metodë mrekullie, por thjesht për një pajisje shtesë, në kuadër të të gjitha mjeteve që ekzistojnë në IAP, për zgjidhjen e konflikteve dhe krijimin e një klime më paqësore në shkollë.

Bazuar në Rregulloren për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës, për të parandaluar dhe reaguar ndaj rasteve të dhunës, çdo institucioni arsimor i sugjerohet të zhvillojë planet zhvillimore dhe plane të veprimit dhe të përcaktojë objektiva, masa dhe aktivitete sistematike që kontribuojnë në parandalimin e të gjitha llojeve të dhunës. Në këtë drejtim është detyrim i IAP që të sigurojnë ngritjen e vetëdijes së nxënësve për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mes vete nëpërmjet ndërmjetësimit jo formal nga bashkëmoshatarët.<sup>19</sup> Në këtë frymë duhet parë dhe zbatuar edhe këtë Udhëzues, i cili “përveç menaxhmentit të shkollës edhe nxënësit duhet të njihen gradualisht me projektin e ndërmjetësimit. Paraprakisht do duhej të realizoheshin një mori aktivitete të përgatitore, informuese për të debatuar dhe kuptuar më mirë me konceptet e ndërmjetësimit si dhe qasja e zgjidhjes paqësore të konflikteve dhe përfitimet nga aktivitetet e ndërmjetësimit në mes të bashkëmoshatarëve.”<sup>20</sup>

### *1.3. Parimet e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor*

Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor është proces në të cilën përfshihen disa veprime që kanë të bëjnë me fëmijën. Si rrjedhojë parimet e përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, si dhe aktet e tjera juridike që rregullojnë çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijës, Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale, Rregulloren për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës, Udhëzimin administrativ (QRK) Nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative, duke përfshirë Ligjin për Ndërmjetësim si dhe Ligjin për arsimin parauniversitar, kanë efekt dhe duhet të zbatohen përshatshmërisht edhe në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor. Parimet e përcaktuara në këto akte e plotësojnë njëra tjetrën dhe përfshihen por nuk kufizohen në parimet si në vijim: Interesi më i mirë i fëmijës; Shprehja e vullnetit; Barazia e palëve; E drejta e fëmijës për t’u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet; Paanshmëria dhe pavarësia, E drejta e fëmijës për t’u trajtuar me dinjitet dhe ndjeshmëri dhe Privatësia dhe konfidencialiteti. Zbatimi i këtyre parimeve është thelbësor për suksesin e procesit të ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, sepse moszbatimi i këtyre parimeve cenon procedurën e ndërmjetësimit dhe si rrjedhojë edhe arritjen e zgjidhjes apo marrëveshjes.

<sup>19</sup> Shih Neni 6 (1.3) dhe Neni 9 (1.8), Rregullore QRK - Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar  
<sup>20</sup> Doracak i Përmblidhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konflikteve mes Bashkëmoshatarëve në Shkollë, Prishtinë, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe ForumZFD, Maj 2019, fq.13 dhe 14.

Pavarësisht që në ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor është që në këtë proces ndërmjetësuesit hyjnë spontanisht në këtë rol, pra secili mund të luajë këtë rol, ndërmjetësuesit duhet të respektojnë këto parime, të cilat në një farë mënyre përbëjnë të drejtat dhe detyrat e ndërmjetësuesve, të cilat në një mënyrë janë edhe garanci e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së procesit të ndërmjetësimit.

### 1.3.1. Interesi më i mirë i fëmijës

*Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve. (Kushtetuta, Neni 50.4)*

Të gjitha masat, veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me nxënësit e përfshirë në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, në të gjitha fazat, të ndërmarra nga palët e përfshira, duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijës dhe interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese, në ndërthurje me të drejtat tjera të fëmijës.

Për të siguruar interesin më të mirë të fëmijëve në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor duhet përkujdesur së paku që:

- ✓ qëndrueshmëria të jetë qëllim kyç, për të siguruar stabilitetin e marrëdhënieve personale të fëmijëve dhe mjedisit dhe për të garantuar vazhdimësinë e shkollimit të fëmijëve;
- ✓ të gjitha masat dhe veprimet të merren dhe zbatohen me shpejtësi dhe pa vonesa të paarsyeshme;
- ✓ të zbatohet një qasje gjithëpërfshirëse, që merr parasysh të gjitha interesat e fëmijës, përfshirë mirëqenien psikologjike, fizike, interesat ligjore, sociale dhe ekonomike;
- ✓ pikëpamjeve dhe mendimeve të nxënësit t'u jepet pesha e duhur, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- ✓ të drejtat e nxënësit, duke përfshirë por mos u kufizuar në të drejtën për dinjitet dhe trajtim të barabartë, duhet të respektohen në çdo kohë;
- ✓ të merret parasysh individualiteti, mosha, pjekuria, faza e zhvillimit, gjuha amtare, gjinia, identiteti, gjendja shëndetësore dhe aftësitë e veçanta të nxënësit me qëllim për ta mbrojtur nxënësin nga ndonjë dëm fizik ose psikologjik.<sup>21</sup>

### 1.3.2. Shprehja e vullnetit

Procesi i ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor zhvillohet me vullnetin e plotë dhe të lirë të nxënësve.<sup>22</sup> Nxënësit janë të lirë të vendosin për zhvillimin e procesit të ndërmjetësimit.<sup>23</sup> Po ashtu, nxënësit nuk janë të obliguara të arrijnë marrëveshje përmes ndërmjetësimit, pa vullnetin e tyre të lirë.<sup>24</sup> Ndërmjetësuesi/ja duhet të kujdeset gjatë

21 Shih Neni 5, Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës (Gazeta Zyrtare, Nr. 14, 17 korrik 2019); Shih Nenin 6 dhe Nenin 7, Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative, dhe Neni 5, Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale.

22 Shih Neni 4, Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim dhe Neni 4.1, Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës,

23 Shih Po aty, Neni 12.2.

24 Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 9.7.

gjithë procesit të ndërmjetësimit se nxënësit me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë marrin pjesë dhe i japin drejtim secilës fazë të procedurës apo largimit nga procesi i ndërmjetësimit.<sup>25</sup>

### 1.3.3. Barazia

Në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmohatarëve në kontekstin shkollor, nxënësit janë të barabartë dhe çdo nxënës ka të njëjtat të drejta të njohura me legjislacionin në fuqi, t'i garantohen ato pa asnjë lloj dallimi. Të gjithë nxënësit, duhet të trajtohen në të gjitha fazat e ndërmjetësimit në mënyrë të barabartë.

Nxënësit duhet të mësohen të respektojnë dhe të vlerësojnë ndryshimet ndërmjet njerëzve, si dhe të kuptojnë paragjykimin, shkaqet dhe mënyrat e veprimit e të shfaqjes së tij.

### 1.3.4. E drejta për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet

Gjatë procesit të ndërmjetësimit, në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me nxënësin, të marra nga të gjitha palët e përfshira, kanë për obligim t'i garantojnë nxënësit, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit në fuqi.<sup>26</sup> Për tu dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet në procesin e ndërmjetësimit, duhet siguruar që nxënësve t'u:

- ✓ jepen informacione adekuate, në mënyrë dhe gjuhë që nxënësit mund t'i kuptojnë, rreth procesit të ndërmjetësimit, rëndësisë dhe efektit të mundshëm të pjesëmarrjes së tyre në këtë proces;
- ✓ garantohet e drejta për të shprehur pikëpamjet e tyre;
- ✓ merret mendimi për çështjet e parashtruara;
- ✓ jepet konsideratë e duhur pikëpamjeve dhe shqetësimeve të tyre, duke i kushtuar vëmendje për atë se çfarë thonë për çdo çështje që ka të bëjë me ta.<sup>27</sup>

Gabimet me të mëdha që bëhen në shumë raste tek konfliktet ndërmjet nxënësve, është kur mendojmë se i dimë qëndrimet e nxënësve, pa komunikuar në mënyrë të efektshme me nxënësit. Duhet kushtuar kujdes të madh dhe të mos vështirësohet komunikimi. Konflikti ndërlikohet me tej për shkak të mosfunksionimit të komunikimit dhe kështu mund të nisë një rreth vicioz brenda të cilit keqësimi i komunikimit dhe shkallëzimi i konfliktit ushqejnë njëri-tjetrin.<sup>28</sup>

25 Shih Neni 4.2, Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve.

26 Shih Neni 12, Konventa, Neni 12.

27 Shih Neni 7, Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës dhe Neni 16 dhe Neni 17, Udhëzimi Administrativ (QRK) – Nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative.

28 Shih dhe krahaso, Doracak për Ekipet ndërmjetësuese mes bashkëmohatarëve, KEC, fq. 16.

### 1.3.5. Paanshmëria dhe pavarësia

Ndërmjetësuesi/ja/ët gjatë zhvillimit të procesit të ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor duhet të mbetet/ën plotësisht i/e/të pavarur dhe i/e/të paanshëm/me dhe duhet të ofrojë shërbimin e tij/saj, vetëm në ato çështje ku mund të mbetet i/e pavarur dhe i/e paanshëm, në të kundërtën duhet të refuzoj ndërmjetësimin, të njoftojnë palët se nuk është në gjendje që të vazhdojë ndërmjetësimin dhe tërhiqet nga rasti përkatës. Njëkohësisht, ndërmjetësuesi/ja/ët duhet të bëjnë trajtimin e barabartë të të gjitha palëve në procedurë, duke shmangur çfarëdo lloj paragjykimi.<sup>29</sup>

### 1.3.6. E drejta e fëmijës për t'u trajtuar me dinjitet dhe ndjeshmëri

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, është përcaktuar në Nenin 23 të Kushtetutës. Prandaj, dinjiteti individual, nevojat e veçanta, interesat dhe jeta private e nxënësve duhet të respektohen dhe të mbrohen, në të gjitha fazat e procesit të ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor dhe çdo nxënës në procedurë duhet trajtuar: si individ me nevojat, dëshira dhe ndjenja individuale, dhe në mënyrë të kujdesshme dhe të ndjeshme gjatë gjithë procesit të ndërmjetësimit.

Për të siguruar trajtim me dinjitet dhe ndjeshmëri në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor duhet marrë në konsideratë nxitja e një qasje të përshtatur dhe një qasje multidisiplinare për nxënësit, duke respektuar të drejtën e tyre për t'u trajtuar me dinjitet, ndjeshmëri dhe kujdes të veçantë.<sup>30</sup>

### 1.3.7. Privatësia dhe konfidencialiteti

Fëmijës i garantohet e drejta për privatësi, respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe duhet të mbrohet nga ndërhyrjet keqdashëse; arbitrare, dhe të kundërligjshme që prekin moralin dhe dinjitetin e fëmijës.<sup>31</sup>

Procesi i ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor është i natyrës konfidenciale, takimet e ndërmjetësimit janë jo-publike dhe gjatë tyre nuk mbahet procesverbal dhe nuk duhet të incizohen. Ndërmjetësuesi/ja/, nxënësit si palë dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë proces, janë të obliguar që të ruajnë konfidencialitetin dhe çdo informacion të ditur në procedurën e ndërmjetësimit.<sup>32</sup>

<sup>29</sup> Shih Neni 6, Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, dhe Neni 3 (1.3 dhe 1.4) dhe Neni 5, Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve.

<sup>30</sup> Shih Neni 12 dhe Neni 13, Udhëzimi Administrativ (QRK) – Nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative.

<sup>31</sup> Neni 39, Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës.

<sup>32</sup> Shih Neni 7, Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 12.8; Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave; Neni 12, Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria, Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, Neni 10, Neni 18 dhe Neni 19, Udhëzimi Administrativ (QRK) – Nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative.

## 1.4. Pjesëmarrësit në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor

### 1.4.1. Nxënësit - palë e përfshirë në procesin e ndërmjetësimit

Në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor marrin pjesë dy apo më shumë nxënës të përfshirë në konflikt dhe një apo më shumë persona në cilësinë e ndërmjetësuesit/ëve.

### 1.4.2. Ndërmjetësuesit në kontekstin shkollor

Ndërmjetësuesi në kontekstin shkollor është personi i tretë, i paanshëm, i cili nuk është i përfshirë direkt në konflikt apo mosmarrëveshje por ndërhyr dhe ndërmjetëson në mes nxënësve për t'u ndihmuar atyre të kërkojnë një rezultat që i shtjellon shqetësimet e tyre në mënyrë të përshtatshme, me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe konflikteve, në pajtim me parimet e ndërmjetësimit.

Ndërmjetësues në kontekstin shkollor mund të jetë gjithsecili, pra mund të jenë nxënësit, mund të jenë mësuesit, mund të jenë drejtorët e shkollës, mund të jenë prindi ose të afërmit.

Secili/la në raste të caktuara mund të ndihmojë në zgjidhjen e një konflikti, varësisht nga rastet dhe situatat. Secili/la mund dhe duhet të luajë një rol të pajtimit në mes të fëmijëve që janë në konflikt. Obligimi i të gjithëve është që të mos qëndrojnë spektator të konflikteve por të bëjnë përpjekje dhe të pajtojnë. Kjo frymë duhet mbajtur dhe secili mësues ka për obligim që këtë frymë ta bartë tek nxënësit dhe të kujdeset që këto të zbatohen. Është e rëndësishme të diskutohet ndërmjetësimi, përfitimet dhe të mirat e tij si temë kurrikulare dhe jashtë kurrikulare. Sidomos në orët standarde të kujdestarisë dhe të edukatës qytetare, duhet të diskutohen çështjet e ndërmjetësimit dhe përmirësimit të klimës së bashkëpunimit duke ofruar mjete dhe rrugët për reflektim dhe diskutim në klasë mbi tema të tilla si: dashamirësia, vetëvlerësimi, respektimi i dallimeve, refuzimi i ngacmimeve, zbutja e konflikteve dhe thashethemeve. Por edhe mekanizmat tjerë në IAP mund dhe duhet të luajnë rol të procesin e krijimit të klimës miqësore në shkollë dhe të ndihmojnë në procesin e ndërmjetësimit.

Me qëllim të informimit të të gjitha palëve në shkollë është e preferuar që mësuesit të trajtojnë tema të ndërmjetësimit.

Përhapja e kulturës së ndërmjetësimit, ndihmon që nxënësit të kenë një qasje jo të dhunshme dhe konstruktive. Në këtë klimë më të qetë, nxënësit fitojnë përgjegjësi dhe pjekuri: fitojnë vetëbesim, të menduarit kritik dhe përmirësojnë aftësitë e tyre komunikuese si dhe zhvillohet respekti për dallimet. Ky ndryshim në mentalitet i mundëson të hapen ndaj një kulture tolerance dhe debati, të përfshihen në projekte kolektive dhe të mësojnë rreth shprehjes qytetare. Njohja e nxënësve me ndërmjetësimin dhe, për disa, trajnimi në ndërmjetësim, është një investim real në favor të arsimit. Përmirësimi i klimës në shkollë ndihmon për të qetësuar nxënësit dhe për të rritur kështu shanset e tyre për suksese.

Përveç kësaj është shumë e rëndësishme që në çdo shkollë të kenë ndërmjetësues më të përgatitur për këtë proces dhe ku do të jetë një adresë për secilin fëmijë që mund t'i drejtohet për ndihmë por edhe për nxënësit tjerë që mund t'i paraqesin këto raste. Në këto raste është e rëndësishme që ndërmjetësuesit të njihen nga nxënësit dhe këta ndërmjetësues të bëhen publik

dhe të njoftohen secili. Prandaj është e nevojshme të sigurohet që një ekip i nxënësve të shkollës dhe mësimit të kenë një përgatitje dhe aftësi të duhura për të luajtur rolin e ndërmjetësuesit.

Duhet pasur parasysh që IAP, ndër të tjera kanë për obligim që të sigurojnë zbatimin e rregullave të brendshme që përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit individ brenda çerdhes/kopshtit/shkollës. Po ashtu, këto institucione, duhet të bashkëpunojnë me Këshillin e Prindërve dhe Këshillin e Nxënësve në iniciativa dhe veprime konkrete për parandalim dhe referim të rasteve të dhunës si dhe të bashkëpunojnë për projektet të ndryshme me organizatat joqeveritare që zhvillojnë programe kundër dhunës në të gjitha relacionet brenda institucioneve arsimore.<sup>33</sup>

Institucionet të cilat merren me parandalimin dhe reagimin ndaj veprimeve të dhunshme në institucionet e arsimit para-universitar,<sup>34</sup> janë edhe institucionet të cilat duhet të lozin një rol të rëndësishëm dhe mund të jenë pjesëmarrës aktiv në procedurën e ndërmjetësimit, të cilat janë të obliguara që të ndërmarrin masa dhe veprime për të parandaluar çfarëdo situatë që sjell deri te shkelja e të drejtave të fëmijëve apo cenimi i mirëqenies së nxënësve. Në këtë kategori bëjnë pjesë: Rrjeti i brendshëm mbrojtës dhe Rrjeti i jashtëm mbrojtës.<sup>35</sup>

Zgjidhja e konflikteve në mes bashkëmoshatarë, nëpërmjet ndërmjetësimit, kërkon një angazhim dhe përfshirje, në radhë të parë të Rrjetit të brendshëm mbrojtës.

Në rastet kur zgjidhja e mosmarrëveshje dhe konflikteve në mes bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, nuk arrihet të bëhet rrjeti i brendshëm mbrojtës, në rast të përsëritjes dhe tendencës së përshkallëzimit të dhunës nga i njëjti nxënës, apo në rastet më të rënda të dhunës dhe konfliktit, atëherë drejtori kërkon ndihmë dhe përfshirje nga rrjeti i jashtëm mbrojtës, sipas mandateve përkatëse të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

#### 1.4.3. Edukatori/ja, mësuesi/ja, arsimtari/ja

Mësimit mund dhe duhet të luajnë një rol të vazhdueshëm në parandalimin e konflikteve, në promovimin e klimës miqësore në klasa dhe shkollë dhe mund të jenë edhe ndërmjetësues në shumë raste në konfliktet ndërmjet fëmijëve. Mësimit për këtë qëllim bashkëpunojnë dhe informojnë kujdestarin/kujdestarët e klasës.

#### 1.4.4. Kujdestari/ja i/e klasës

Kujdestari/ja e klasës kanë obligim që të përkujdesen për sjelljen e nxënësve në shkollë dhe duhet të luajnë një rol të vazhdueshëm në promovimin e zbatimit të rregullave të shkollës duke përfshirë edhe promovimin e ndërmjetësimit. Kujdestarët duhet të luajnë një rol të vazhdueshëm edhe si ndërmjetësues dhe të ndikojnë në mbajtjen e klimës miqësore të

33 Shih Neni 9, Rregullore QRK - Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar (20.09.2013)

34 Shih Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar dhe Rregullore QRK - Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar (20.09.2013)

35 Shih Neni 4, Rregullore QRK - Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar (20.09.2013)

nxënësve. Njëkohësisht, në orët e kujdestarisë duhet ti kushtojnë në vazhdimësi sjelljes dhe raporteve të fëmijëve dhe të promovojnë dialogun e hapur për problemet dhe zënkat e ndryshme në klasë dhe në shkollë. Në këtë drejtim kërkojnë mendimet dhe propozimet edhe të Kryesisë së klasës. Kujdestarët për këtë qëllim bashkëpunojnë dhe informojnë drejtorin.

#### 1.4.5. Kryesia e klasës

Kryetari dhe anëtarët e kryesisë së klasë kanë për obligim që të përkujdesen për një ambient miqësor në klasë dhe në shkollë. Këta duhet të përpiqen në vazhdimësi të jenë pjesë e parandalimit dhe pajtimit të konflikteve të ndryshme ndërmjet nxënësve të klasës dhe nxënësve të klasave të tjera. Kryesia duhet të bashkëpunojë ngushtë me Kujdestarin dhe mësimdhënësit dhe të informojnë dhe kërkojnë ndihmë sipas nevojë në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme ndërmjet nxënësve.

#### 1.4.6. Drejtori i shkollës

Drejtori i shkollës ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin përgjithshëm të institucionit, që përfshinë por nuk kufizohet në caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve dhe për disiplinën dhe çështjet e tjera të arsimit.<sup>36</sup> Në raste të ndryshme të raportuara të dhunës në shkollë, drejtori duhet të bashkëpunojë ngushtë me kujdestarët dhe mësimdhënësit dhe të diskutojnë për gjetjen e zgjidhjeve paqësore. Sipas rasteve drejtori cakton edhe menaxherin e rastit. Drejtori po ashtu, mund të jetë ndërmjetësues në rastet kur e konsideron që është në interesin më të mirë të fëmijës, ndërhyrjen e tij/saj në zgjidhjen e ndryshme të konflikteve.

#### 1.4.7. Menaxheri/përgjegjësi i rastit të caktuar nga drejtori

Menaxheri/përgjegjësi i rastit të caktuar nga drejtori, duhet të ketë qëllim jo vetëm hulumtimin e rastit të dhunës apo konfliktit por të merret edhe gjetjen e opsionit të pajtimit dhe të ndërmjetësorë në rastet kur është në interesin më të mirë të fëmijës. Menaxheri/përgjegjësi i rastit për këtë qëllim bashkëpunojnë me kujdestarin/kujdestarët e klasës si dhe informojnë drejtorin.

#### 1.4.8. Këshilli drejtues

Këshilli drejtues i institucioneve publike arsimore dhe aftësuese, gjatë zbatimit të kompetencave dhe detyrave të tij, në hartimin e rregullave të shkollës për të promovuar sjelljen e mirë dhe disiplinën e nxënësve, dhe për të promovuar konceptin e shkollave të shëndetshme dhe eliminimin e dhunës duke përfshirë edhe të drejtat dhe detyrimet e nxënësve që janë të bazuara gjithmonë në legjislacionin në fuqi, duhet të ndërmarrin masa dhe veprime që të zbatohet ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve.<sup>37</sup> Drejtori dhe kujdestarët bashkëpunojnë me Këshillin Drejtues dhe propozojnë sipas nevojë zbatim të ndërmjetësimit

<sup>36</sup> Shih Neni 20, Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

<sup>37</sup> Shih Po aty, Neni 17 dhe Neni 22, Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor. Në raste të caktuar, kur është në interesin më të mirë të fëmijës, Këshilli drejtues mund të propozojë ndërmjetësues, që do të zgjidhin konflikte të caktuara të nxënësve. Këshilli Drejtuesi në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Prindërve dhe Këshillin e Nxënësve analizojnë të dhënat mbi dhunën e paraqitur në kuadër të institucionit ku vepron, dhe rekomandon marrjen e masave dhe veprimeve të mëtejme, duke përfshirë edhe marrjen e masave për zgjidhjen paqësore përmes ndërmjetësimit.

#### 1.4.9. Këshilli i prindërve

Çdo institucion arsimor apo aftësues duhet të ketë këshill të prindërve. Këshilli i prindërve zgjidhet me vota të fshehta të gjithë prindërve të nxënësve që vijnë në atë institucion. Prindërit, përveç përfaqësimit në Këshillin e Prindërve, kanë të drejtë t'i paraqesin ankesat e tyre, drejtorit të institucionit arsimor dhe aftësues, komunës dhe Ministrisë lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe mjedisin shkollor.<sup>38</sup> Prindërit kanë rol të madh në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve. Në çdo rast kur vlerësojnë dhe kur është në interesin më të mirë të fëmijës, mund të marrin pjesë apo të propozojnë prindër që mund të ndihmojnë dhe mund të jenë ndërmjetësues.

#### 1.4.10. Këshilli i Nxënësve

Duke marrë parasysh që roli i Këshillit të Nxënësve është të punojë në përmirësimin e mjedisit mësimor, kushteve të punës dhe interesave që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve si dhe të përfaqësohen në Këshillin Drejtues.<sup>39</sup> Këshilli i Nxënësve mund të luajë rol edhe në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve.

#### 1.4.11. Shërbimet tjera profesionale dhe mbështetëse

Edhe Shërbimet tjera profesionale dhe mbështetëse në shkolla siç janë: pedagogu, psikologu, Sekretari ose administratori,<sup>40</sup> dhe shërbimet tjera mbështetëse në shkolla, mund dhe duhet të japin kontributin e tyre në ndërmjetësimin ndërmjet nxënësve dhe mund të jenë edhe ndërmjetësues në rastet e caktuara. Këta për këtë qëllim bashkëpunojnë dhe informojnë kujdestarin e klasës dhe drejtorin e shkollës.

### 1.5. Ndërmjetësimi “nga, për, me dhe ndërmjet të nxënësve/fëmijëve”

Veçantia e procesit të ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor është që ndërmjetësues janë edhe vetë nxënësit. Në këto raste kemi të bëjmë me ndërmjetësim: “nga, për, me dhe ndërmjet të nxënësve”. Çdo shkollë duhet të ndërtojë sistemin që në mesin e nxënësve të ketë Ndërmjetësues të cilët edhe mund të themelojnë Klubit/Ekipe për

<sup>38</sup> Shih Neni 19, Ligji nr. 04/L-052 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

<sup>39</sup> Shih Po aty, Neni 18.

<sup>40</sup> Shih Po aty, Neni 21.

ndërmjetësim në mes të bashkëmoshatarëve. Nxënësit ndërmjetësues përzgjidhen në mënyrë vullnetare dhe pas kalimit të ndonjë trajnimi apo testimi që mund të organizohet nga shkolla. Zgjidhja më e mirë është që të ketë një gjithë përfshirje dhe që së paku një nxënës të jetë në një klasë, gjithnjë duke marrë parasysh që përzgjedhjen edhe në aspektin e barazisë gjinore dhe nga radhët e komuniteteve (në ato raste kur ka të tillë).

Është shumë e rëndësishme që me ndërmjetësues nxënës mund të zgjidhin shumë konflikte mes nxënësve. Sidomos, mund të kontribuojnë në zgjidhjen e konflikteve të vogla ditore midis bashkëmoshatarëve, dhe ndihmojnë në krijimin e një klime më të mirë në shkollë. Janë një mjet për të luftuar, në burim, konfliktet. Kjo metodë e zgjidhjes së konflikteve nga vetë nxënësit është një sistem edukimi për të jetuar së bashku, i bazuar në dëgjimin, të kuptuarit e ndjenjave të njëri-tjetrit dhe gjetjen e një marrëveshjeje të kënaqshme për nxënësit.

### 1.6. Detyrat e ndërmjetësuesve

Në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, roli kryesor i ndërmjetësuesit/es është që të lehtësojë zgjidhjen vullnetare të konfliktit apo mosmarrëveshjes dhe duhet t'u ofrojë mundësinë palëve që të hulumtojnë të gjitha mundësitë për zgjidhjen e saj. Ndërmjetësuesi/ja mund të propozoj mundësi për zgjidhjen e konfliktit apo mosmarrëveshjes, por jo edhe vet zgjidhjen.<sup>41</sup>Për të pasur sukses ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor është shumë e rëndësishme që ndërmjetësuesit, të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- ✓ të zbatojnë e parimet e ndërmjetësimit;
- ✓ të jenë të paanshëm dhe të pavarur;
- ✓ të jetë i pranueshëm nga të dy palët;
- ✓ të trajtojnë me seriozitet problemin duke mos i gjykuar nxënësit;
- ✓ të vënë theksin tek ajo që i bashkon nxënësit e përfshirë në konflikt, sesa tek ajo që i ndan ato;
- ✓ gjatë procesit të negociimit të bëjnë deklaratatë të qarta dhe koncize;
- ✓ të synojnë parandalimin e situatave konfliktuoze dhe të menaxhojnë situata konflikti, si rrjedhojë të fokusohen në nevojat dhe jo në pozicionet, që mund të bartin nxënësit në konflikt;
- ✓ duhet të jenë fleksibël ndaj opsioneve, që nxënësit hedhin si mundësi për zgjidhjen e konfliktit dhe të ofrojnë udhëzime për të ndihmuar nxënësit e përfshirë në procesin e ndërmjetësimit;
- ✓ takojnë nxënësit në konflikt dhe të përpiqen të sjellin zgjidhje nga vetë ata. Është qasja “me ata/ato-për ata/ato”;
- ✓ të kontribuojnë në mënyrë efektive në përpjekjen për të zhvilluar takimet e ndërmjetësimit duke krijuar një atmosferë pozitive për të krijuar besim tek nxënësit dhe lehtësojnë dialogun në mes të nxënësve;
- ✓ të bëhet planifikimi i seancave të ndërmjetësimit dhe të tentohet që këto të mos zgjasin shumë;

<sup>41</sup> Shih dhe krahaso Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, Neni 7.1

- ✓ të përkujdeset që secilit nxënës t'i jepet mundësia të shprehë mendimet, apo komentet e veta;
- ✓ në rastin e bashkë-ndërmjetësimit, ndërmjetësuesit paraprakisht t'i përcaktojnë rolet dhe të koordinohen së bashku;
- ✓ ofrojnë mbështetje individuale ose kolektive për të siguruar që procesi i ndërmjetësimit do të rezultojë i suksesshëm.

Si rrjedhojë, cilësitë e nevojshme të ndërmjetësuesit janë: aftësia për të komunikuar, qetësia, ndjeshmëria, paanshmëria, diskrecioni (ndërmjetësimi duhet të jetë konfidencial për të nxitur krijimin e marrëdhënieve të besimit midis pjesëmarrësve në procesin e ndërmjetësimit).

### 1.7. Përparësitë/Ndikimet e ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor:

- ✓ Parandalon kryerjen e veprave penale të nxënësve, menaxhon dhe zvogëlon dhunën, konfliktet dhe ngacmimet ndërmjet nxënësve;
- ✓ Parandalon, menaxhon dhe zvogëlon dhunën, konfliktet dhe ngacmimet ndërmjet nxënësve;
- ✓ Ndhmon në krijimin e një klimë më të qetë në shkollë;
- ✓ Është në shërbim të mirëqenies dhe suksesit të nxënësve;
- ✓ Ndikon që nxënësit të fitojnë vetëbesim dhe të ndihen më mirë në shkollë;
- ✓ Ndhmon në parandalimin e braktisjes së shkollës;
- ✓ Ndhmon në vijueshmërinë e rregulltë në shkollë;
- ✓ Ndhmon në përvetësimin e një kulture dialogu dhe tolerance,
- ✓ Kontribuon në pranimin e dallimeve dhe respektin për dinjitetin e tjetrit dhe të mësuarit e tyre për "të jetuarit më mirë së bashku".

## II. FAZAT E PROCESIT TË NDËRMJETËSIMIT NDËRMJET BASHKËMOSHATARËVE NË KONTEKSTIN SHKOLLOR

### 2.1. *Inicimi i procesit të ndërmjetësimit - Referimi në ndërmjetësim*

Procesi i ndërmjetësimit mund të iniciohet nga palët apo nga nxënësit, mësimmshënësit, drejtori i shkollës, prindërit ose të afërmit, dhe personat tjerë. Si rrjedhojë kemi dy lloje të proceseve të ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor:

- (1) Procesi i ndërmjetësimit me vetë-inicim të palëve - Proceset e iniciuara nga vetë nxënësit, dhe
- (2) Procesi i ndërmjetësimit të referuar - Proceset e ndërmjetësimit të iniciuara nga personat tjerë.

Të gjitha rastet e dhunës të paraqitura në shkollë duhet të shqyrtohen menjëherë nga IAP, duke pasur parasysh çdo herë interesin më të mirë të fëmijës. IAP që në fillim duhet shqyrtuar mundësinë dhe të kenë parasysh që rasti të referohet në ndërmjetësim.

IAP kur vjen në dijeni se fëmiu ka nevojë për mbrojtje dhe trajtim nga shërbimet profesionale sipas mandatit të përcaktuar me ligj dhe referon rastin e dhunës në Qendër për Punë Sociale, edhe në këto raste, Menaxheri i rastit nga QPS, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të rastit, duhet të njoftojë me shkrim drejtorin e IAP-së për veprimet që janë ndërmarrë për t'i dalë në ndihmë fëmiut. Menaxheri në bashkëpunim me IAP duhet të shqyrtojë mundësinë dhe rastin ta referojë edhe në ndërmjetësim joformal.<sup>42</sup>

Në këtë drejtim, duhet shqyrtuar edhe cilat raste të referohen në ndërmjetësim dhe cili dhe si do të ishte mundësia e përfshirjes dhe angazhimi i prindërve dhe komunitetit për të kontribuar në zgjidhjen e konfliktit. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse "Shkolla dhe familja janë dy sisteme të ndërlidhura dhe se bashkëpunimi reciprok sjell shumë përfitime si tek nxënësit, mësimmshënësit dhe shoqëria."<sup>43</sup>

### 2.2. *Pajtimi i palëve për zhvillimin e ndërmjetësimit*

Nxënësit e përfshirë në konflikt, me vullnetin e lirë të tyre, duhet të pajtohen për zhvillimin e procesit të ndërmjetësimit. Si hap i parë, ata/o duhet të pajtohen që të zgjidhin konfliktin apo mosmarrëveshjen e tyre përmes ndërmjetësimit.<sup>44</sup> Pas pajtimit për fillimin e procesit të ndërmjetësimit dhe para se të fillojë procesi i ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi/ja është i/e obliguar t'i informojë palët për parimet dhe rregullat e marrëveshjes,<sup>45</sup> duke përfshirë por mos u kufizuar në:

- ✓ Të drejtën e palëve për të vendosur në lidhje me procesin e ndërmjetësimit;
- ✓ Të drejtën e ndërmjetësuesit/es dhe të palëve për të përfunduar ose ndërprerë ndërmjetësimin;

<sup>42</sup> Shih Neni 23, Rregullore QRK - Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar (20.09.2013)

<sup>43</sup> Shih, Doracak i Përmbljedhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konfliktive mes Bashkëmoshatarëve në Shkolla, Prishtinë, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe ForumZFD, Maj 2019, fq.22.

<sup>44</sup> Shih dhe krahaso Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 12.

<sup>45</sup> Shih dhe krahaso Po aty, Neni 11.1.

- ✓ Ruajtjen e fshehtësisë të komunikimeve dhe dokumenteve.<sup>46</sup>

Në procedurën e ndërmjetësimit, të drejtat dhe detyrimet e ndërmjetësuesit/es dhe palëve duhet të specifikohen para fillimit të procedurës, si rrjedhojë palët e përfshira duhet t'u përmbahen këtyre deri në përfundim të procedurës dhe pas saj.<sup>47</sup>

### 2.3. Takimet e ndërmjetësimit

Nxënësit e përfshirë në konflikt apo mosmarrëveshje, gojarisht japin pëlqimin për fillimin e procesit të ndërmjetësimit. Pas pëlqimit për fillimin e procesit të ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi/ja/ët në pajtim me nxënësit, do të caktojë kohën dhe mënyrën e zhvillimit të takimeve të ndërmjetësimit.<sup>48</sup>

Takimet e ndërmjetësimit janë takimet e ndërmjetësuesit/es/ëve me nxënësit, me qëllim të zgjidhjes së konflikteve apo mosmarrëveshjeve. Takimet e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmohatarëve janë jo-publike dhe gjatë mbajtjes së tyre nuk mbahet procesverbal dhe nuk duhet të incizohen.<sup>49</sup>

Shkollat sugjerohet të sigurojnë mjedise të mbrojtura, të sigurta dhe atraktive në shkollë ku nxënësit komunikojnë lirshëm për brengat e tyre, mbështesin njëri-tjetrin dhe mësojnë përvoja të reja. Për të mundur punën efektive të ndërmjetësuesve/ekipeve/klubeve të ndërmjetësimit është e rëndësishme që shkolla të caktojë një hapësirë/ klasë ku ndërmjetësuesit mund të takohen për të koordinuar aktivitetet e tyre dhe zhvillimin e takimit të ndërmjetësimit. Sugjerohet që hapësira të jetë e përshtatshme, lehtë e qasshme, e identifikueshme, e pajisur me mjetet e materiale që promovojnë zgjidhjen paqësore të konflikteve, të mirëmbajtura si dhe të sigurohet konfidencialitet në zhvillimin e aktiviteteve. Krijimi i hapësirave të tilla dhe përdorimi i tyre me qëllim të bashkimit të nxënësve për të diskutuar aspekte të ndryshme që i preokupon, i bën të vetëdijshëm për vlerat demokratike, potencialet njerëzore dhe mundësitë e barabarta që i ndihmojnë secilit nxënës të zhvillojë tolerancën, vlerësimin dhe çmuarjen e përvojave të secilit individ.<sup>50</sup>

Takimet e ndërmjetësimit zhvillohen sipas fazave si në vijim:

- ✓ Ndërmjetësuesi para fillimit të procesit të ndërmjetësimit njofton nxënësit rreth procesit të ndërmjetësimit dhe rolin e tyre në ndërmjetësim;
- ✓ Ndërmjetësuesi u shpjegon nxënësve në konflikt, rregullat që do t'i ndjekin gjatë procesit, mënyrën se si do të komunikojnë, kohën që do të kenë në dispozicion etj.;
- ✓ Pas kësaj, u jepet me radhë fjala nxënësve në konflikt (fillimisht nxënësve si palë e dëmtuar) që të shpjegojnë se çfarë ka ndodhur dhe pse janë konfliktuar. Gjatë kësaj faze, ndërmjetësuesi më shumë dëgjon dhe mund të bëjë pyetje të hapura për të nxitur nxënësit që të flasin;

46 Shih Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve, Neni 13.1

47 Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 24

48 Shih dhe krahaso. Po aty, Neni 12.50

49 Po aty, Neni 12.

50 Doracak i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konflikteve mes Bashkëmohatarëve në Shkolla, Prishtinë, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe ForumZFD, Maj 2019, fq.19.

- ✓ Nëse ndërmjetësuesi vëren se palët janë mjaft të konfliktuara dhe procesi ngec për shkak se ato grinden përsëri në praninë e tij, atëherë ndërmjetësuesi e ndërpret procesin dhe lë një takim në një ditë tjetër me secilën palë veç e veç. Në rast se palët në takimet e veçanta tregojnë gatishmëri për t'u ulur prapë në tryezën e diskutimit, atëherë ai rinis procesin me të dyja palët së bashku;
- ✓ Ndërmjetësuesi seleksionon (fton) edhe persona të tjerë nga rrethi familjar ose shoqëror i palëve të konfliktuara, të cilët mund të shërbejnë si lehtësues në zgjidhjen e konfliktit;
- ✓ Ndërmjetësuesi i orienton palët që t'i shfaqin njëra-tjetrës interesat dhe të drejtat e tyre, si dhe kushtet për të dale nga konflikti.;
- ✓ Ndërmjetësuesi nuk jep zgjidhje të gatshme dhe nuk bën sugjerime. Nga shpjegimet e palëve, ai vëren nëse ka pika të përbashkëta takimi, në të cilat mund të përputhen këto interesa dhe të drejta. Ai vetëm lehtëson palët që të arrijnë marrëveshjen.<sup>51</sup>

#### 2.4. Marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit

Marrëveshja e ndërmjetësimit është marrëveshje e arritur nga palët dhe ndërmjetësuesi/ja për zgjidhjen e kontestit apo mosmarrëveshjes ndërmjet palëve në procedurën e ndërmjetësimit.<sup>52</sup> Zakonisht marrëveshjet e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor janë marrëveshje gojore dhe nuk ka nevojë që të bëhen në formë të shkruar. Mirëpo, në situata të caktuara të konflikteve me serioze dhe kur është vullneti i palëve në konflikt dhe apo kur vlerësohet se është në interesin më të mirë të fëmijës edhe këto marrëveshje mund të bëhen në formë të shkruar. Në këto raste, marrëveshja duhet të jetë e qartë dhe duhet të përfshijë të gjitha pikat për të cilat palët janë marrë vesh. Ndërmjetësuesi/ja është i/e obliguar që pas përpilimit me shkrim të marrëveshjes për zgjidhjen e ndërmjetësuar dhe para se palët apo përfaqësuesit e tyre ta nënshkruajnë atë, të sigurohet se e ka pasqyruar saktë dhe drejtë vullnetin e palëve në marrëveshje dhe të njëjtën e lexon me zë për ta konfirmuar se palët nuk kanë vërejtje në tekstin e hartuar. Më pas, ndërmjetësuesi/ja ju kërkon palëve të japin komente para se të iniciohet procesi i nënshkrimit, dhe vetëm pasi palët të pajtohen me përmbajtjen e marrëveshjes atëherë finalizohet marrëveshja dhe nënshkruhet nga palët dhe nga ndërmjetësuesi/ja.<sup>53</sup> Ndërmjetësuesi/ja nuk e ruan marrëveshjen e shkruar të arritur në ndërmjetësim në mes palëve dhe marrëveshjen e dërgon tek drejtori i shkollës, i cili ruan këtë marrëveshje dhe pas përfundimit të shkollimit të nxënësve, nënshkruet të marrëveshjes i shkatërron, këto marrëveshje. Palët nuk pajisen me marrëveshjen për zgjidhjen e ndërmjetësuar dhe në rast të kontestimit të saj mund të kërkon nga drejtori konfirmimin e marrëveshjes së arritur më parë për kontestin e zgjidhur.<sup>54</sup>

51 Shih Doracak për Ekipe të ndërmjetësueses në bashkëmoshatarëve, KEC, fq. 27.

52 Shih Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 3 (1.6)

53 Shih: Ligji nr. 06/L-009 për ndërmjetësim, Neni 3 (1.6) dhe Neni 14; Udhëzimi Administrativ (MD) nr. 05/2021 për përcaktimin e procedurës së ndërmjetësimit të vetëinicit të rasteve dhe rasteve të referuara nga organi administrativ, Neni 10; Rregullore (K.GJK) nr. 04/2019 për procedurën e ndërmjetësimit të lëndëve të gjykatave, Neni 13; Rregullore (KPK) nr. 04/2019 për procedurën e ndërmjetësimit të rasteve nga prokuroria, Neni 13

54 Shih dhe krahaso Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 05/2021 për Përcaktimin e Procedurës së Ndërmjetësimit të Vetë-inicimit të Rasteve dhe Rasteve të Referuara nga Organi Administrativ, Neni 13.2

Në rastet kur arrihet marrëveshja lidhur me procesin e ndërmjetësimit, përdoret Shtojca 4 e këtij Udhëzuesi: Forma e Marrëveshjes e arritur në ndërmjetësim ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor.

### 2.5. *Ndërprerja dhe përfundimi i procesit të ndërmjetësimit*

Ndërmjetësuesi/ja ndërprejnë procedurën e ndërmjetësimit nëse vëren se në mes të nxënësve ka të meta në shprehjen e vullnetit të lirë të palëve.

Ndërmjetësimi ndërmjet nxënësve përfundon në rastet e mëposhtme:

- ✓ kur arrihet marrëveshja ndërmjet bashkëmoshatarëve;
- ✓ kur pala heqë dorë (tërhiqet) nga ndërmjetësimi;
- ✓ kur ndërmjetësuesi/ja përcakton se vazhdimi i ndërmjetësimit nuk do të ishte produktiv;
- ✓ kur palët nuk arrijnë marrëveshje për zgjidhjen e kontekstit apo mosmarrëveshjes së tyre.

Marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit, është obligative vetëm për nxënësit që janë në kontest apo mosmarrëveshje.<sup>55</sup>

Në rastet e përfundimit apo të ndërprerjes së ndërmjetësimit, njoftohet drejtori i shkollës, sipas Shtojcës 3 të këtij Udhëzuesi.

---

<sup>55</sup> Shih: Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Neni 14; Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, Nenet 22, 23, 25 si dhe Udhëzuesin me Modelet e Marrëveshjes së Ndërmjetësimit. USAID, Prill 2021

### III. AFTËSIMI PROFESIONAL DHE PROMOVIMI I NDËRMJETËSIMIT NDËRMJET BASHKËMOSHATARËVE NË KONTEKSTIN SHKOLLOR

#### 3.1. *Aftësimi për ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor*

Zhvillimi profesional me bazë në shkollë duhet të jetë edhe pjesë e aftësimit për ndërmjetësim ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor.

IAP organizojnë trajnime për ndërmjetësimin për t'u pasuruar ndërmjetësuesit/et me njohuri të reja për ushtrimin e ndërmjetësimit. Një obligim i tillë i IAP rrjedhë nga Ligji për mbrojtjen e fëmijës (Neni 63), sipas të cilit IAP, në kuadër të përgjegjësiave dhe obligimeve të tyre, janë të obliguara që të zbatojnë programe edukativo-arsimore që sensibilizojnë mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijës dhe mjetet mësimore të përdorura dhe kurrikulat shkollore të zbatueshme në të gjitha nivelet duhet të orientohen në mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijës, dhe kjo duhet të bëhet me përfshirjen e perspektives së mbrojtjes së fëmijës dhe eliminimin e stereotipave negative, gjinore, paragjyqimeve dhe praktikave të tjera që janë në kundërshtim me parimet e përcaktuara në këtë Ligj dhe zhvillimin e udhërrëfyesve për mbrojtjen e fëmijës nga informatat dhe materialet e dëmshme. Në këtë frymë duhet të zhvillohen edhe trajnimet për ndërmjetësim të cilat njëkohësisht edhe sensibilizojnë mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijës.

##### 3.1.1. *Përzgjedhja e nxënësve si ndërmjetësues*

Është e një rëndësie të veçantë që shkollat të përfshihen në mënyrë vullnetare dhe të zotohen se do përkrahin zbatimin e ndërmjetësimit. Në këtë kontekst është gjithashtu vendimtare dhe e pakontestueshme që nxënësit, mësimdhënësit dhe personat tjerë në IAP, që do të përfshihen në si ndërmjetësues, të jenë gjithashtu të përfshirë në mënyrë të pavarur dhe vullnetare pa asnjë imponim të vetëm nga ana e askujt dhe të përzgjidhen në mënyrë objektive. Sepse një qasje e tillë e përfshirjes së nxënësve, mësimdhënësve dhe personave tjerë në IAP, do të ndikojë në integritetin e tyre në procesin e ndërmjetësimit, paanshmëri, besueshmëri dhe efikasitet. Për shkak të kompleksitetit të veprimeve në procesin e ndërmjetësimit rekomandohet të përfshihen nxënësit e klasave më të larta se klasa e pestë. Pra një përzgjedhje nga të gjitha nivelet klasore. Gjithashtu, duhet të ketë një diversitet të nxënësve nga aspekti gjinor, komunitetet (nëse shkolla ka komunitete të ndryshme), statusit socio-ekonomik të familjes si dhe arritjeve akademike në shkollë (pra jo vetëm nxënësit shembullorë dhe të "privilegjuar"). Gjithashtu një segment i rëndësishëm i projektit janë edhe grupet përkrahëse, pra nxënës që nuk do të jenë direkt të përfshirë në procesin e ndërmjetësimit por që do ndihmojnë këtë proces duke marr pjesë në informimin e nxënësve të tjerë për këtë aktivitet përmes fushatave të dizajnuara në shkollë, identifikimin e rasteve dhe referimin e tyre tek grupet ndërmjetësuese. Grupet mbështetëse mund të formohen edhe në klasat si paralele të ndara të shkollave më të mëdha sidomos në pjesët rurale.<sup>56</sup>

<sup>56</sup> Doracak i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konfliktëve mes Bashkëmoshatarëve në Shkollë, Prishtinë. Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe ForumZPD, Maj 2019, fq.15.

Formimi i ekipeve/klubeve të ndërmjetësimit duhet të formalizohet, duke caktuar rolet dhe përgjegjësitë e ekipeve/klubeve të formuara, kohën dhe mënyrën e takimeve koordinuese si dhe planin e veprimit.<sup>57</sup>

### 3.1.2. Përgatitja dhe ngritja e kapaciteteve për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve

Fuqizimi i aktiviteteve me bazë në shkollë duhet të zbatohet edhe me aktivitete të veçanta për organizimin e trajnimeve për ndërmjetësim si dhe për përgatitjen e një numri të nxënësve dhe stafit të shkollës, për parimet e përgjithshme dhe teknikat e ndërmjetësimit në mes të nxënësve. Trajnimet rekomandohet të përsëriten çdo vit dhe të përfshihen grupet e ndërmjetësimit në këto trajnime. Realizimi i trajnimeve dhe seminareve në parandalimin e konflikteve ndihmon që mësimitdhënësit, stafi i shkollës dhe nxënësit e të zhvillojnë shkathtësi për menaxhimin e situatave të ndryshme të konflikteve. Çdo vit një numër i nxënësve përfundojnë shkollën dhe duhet që të plotësohen/ trajnohen me ndërmjetësues të rinj. Në trajnime sugjerohet të përfshihen mësimitdhënësit, prindërit si dhe anëtarë të Këshillit drejtues të shkollës (apo anëtarë nga komuniteti përreth shkollës) me qëllim që të krijohet kulturë e punës së përbashkët për të adresuar dhe menaxhuar konfliktet nga vet shkolla, po ashtu të ngritet vetëdija e reagimit dhe raportimit sa i përket mbrojtjes dhe sigurisë në shkollë. Organizimi i sesioneve këshilluese periodike me prindër dhe nxënës mund të ndikojë në rritjen e ndërgjegjësimit të të gjithë akterëve në shkollë.<sup>58</sup>

Konfliktet ndërmjet nxënësve në shkollë/klasë në shumë raste mund të rriten kur nxënësit ose mësimitdhënësit nuk dinë se si t'i trajtojnë ato. Duke pasur parasysh ndikimin e madh që ka sjellja e mësimitdhënësit në klasë, është shumë e rëndësishme zhvillimi i aftësive për të parandaluar dhe zgjidhur konfliktet në shkollë, të cilat ndër të tjera, synojnë të zhvillojnë aftësitë e mësimitdhënëseve dhe nxënësve:

- ✓ për të menaxhuar konfliktet;
- ✓ për vendosjen e mirëkuptimit në mjedisin shkollor;
- ✓ për të vlerësuar, në mjedisin e shkollës dhe me gjerë, sjelljet dhe qëndrimet, që ndihmojnë në parandalimin ose në zgjidhjen paqësore të konflikteve;
- ✓ për krijimin e ndjenjës së bashkësisë në klasë, si faktor i rëndësishëm jo vetëm për zbutjen e konflikteve, por edhe për trajtimin e tyre në mënyrë krijuese e konstruktive.
- ✓ se si ti mësojnë nxënësit të punojnë së bashku, të besojnë, të ndihmojnë dhe të ndajnë gjithçka me njëri-tjetrin;
- ✓ për fitimin e njohurive, të aftësive, të shprehive dhe të qëndrimeve të domosdoshme për trajtimin dhe zgjidhjen krijuese dhe paqësore të konflikteve në mes bashkëmoshatarëve në mjedisin shkollor;
- ✓ t'i mësojnë nxënësit se si të kontrollojnë veten, kur shprehin ndjenjat, të mos jenë agresivë dhe shkatërrues, veçanërisht, në rastet kur shprehin zemërimin dhe shqetësimin e tyre.
- ✓ t'i mësojnë nxënësit për t'i trajtuar konfliktet në mënyrë sa me efektive e konstruktive.<sup>59</sup>

<sup>57</sup> Shih Po aty, fq.16.

<sup>58</sup> Shih Po aty, fq.17.

<sup>59</sup> Shih Doracak për Ekipe të ndërmjetësuesve mes bashkëmoshatarëve, KEC, fq. 21-23

### 3.1.3. Emërimi dhe certifikimi i nxënësve për ndërmjetësim

Në fund të trajnimit është e rëndësishme që nxënësit të certifikohen për trajnimin me një ceremoni formale të certifikimit si dhe të përcaktohet roli i tyre në shkollë duke pasur kujdes që të mos cenohet integriteti i tyre dhe koha që dedikojnë për këtë aktivitet, të mos ndikojë me procesin mësimor dhe aktivitetet tjera edukative obligative. Po ashtu, përbërja e ekipit të ndërmjetësimi duhet të jetë e njohur për të gjithë pjesëtarët e shkollës, mund të vendoset si poster (letër informuese) që pasqyron se kush janë anëtarët e ekipit si dhe funksionin e tyre.<sup>60</sup> Shkolla ju përgatit dhe shpërndan certifikatat nxënësve, mësimdhënësve dhe personave tjera të cilët certifikohen për ndërmjetësues. Të gjithë këta persona të certifikuar si ndërmjetësuesit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor si dhe personave që marrin pjesë si ndërmjetësues në këtë proces, duhet të nënshkruajnë Deklaratën nën betim, sipas shtojcës 2 të këtij Udhëzuesi.

### 3.2. Promovimi i ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor

IAP gjatë hartimit të kalendarit vjetor të aktiviteteve shkollore jashtë-kurrikulare, duhet të përfshijnë edhe aktivitete promovuese për ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor. Aktivitetet jashtë-kurrikulare duhet të konsiderohen si një pjesë e rëndësishme e përfshirjes sociale por edhe aktivizimit të të gjithë nxënësve pa dallim për të genë përfitues dhe pjesëmarrës aktiv në këto aktivitete. Aktivitetet jashtë kurrikulare të udhëhequra nga nxënësit ndërmjetësues dhe përkrahës mund të zhvillohen me metodologji të ndryshme pune, si: ligjërata, debate, aktivitete artistike me temë kundër dhunës; me raste të imagjinuara (simulimi i rasteve fiktive); lojës me role, dramatizimit, lojëra sociale, aktivitete garuese, shfaqje teatrale, ekspozitat me punime artistike e të tjera. Po ashtu, mund të realizohen edhe aktivitete vetëdijësuese të llojllojshme në bashkëpunim me organizatat joqeveritare.”<sup>61</sup> Aktivitete alternative- jashtë kurrikulare për të sensibilizuar dhe aktivizuar nxënësit në shkollë, si dhe për të bërë promovimin e qasjes së zgjidhjeve paqësore të konflikteve përmes artit, lojës me role, dramatizimit dhe debateve mund të jenë si në vijim:

- ✓ Realizimi i punëtorive krijuese me nxënësit për të drejtat e nxënësve, përmes ekspozitave të arteve figurative, shfaqje teatrale, projektimit të filmave të shkurtër dhe orëve letrare;
- ✓ trajnime dhe aktivitete që promovojnë komunikimin, diversitetin dhe ndihmën e ndërsjellët;
- ✓ “Imagjino një ditë”, aktiviteti i nxënësve në dy grupe me sjellje të mira dhe jo të mira; debat pas një aktiviteti të tillë;
- ✓ Realizimi i ekspozitave artistike në fushën e zgjidhjes paqësore të konflikteve;
- ✓ Përpilimi dhe shpërndarja e posterave, broshurave dhe fletëpalosjeve për ndërmjetësimin si dhe forma tjera të informimit dhe promovimit të ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve;

<sup>60</sup> Doracak i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konflikteve mes Bashkëmoshatarëve në Shkollë, Prishtinë. Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe ForumZFD, Maj 2019, fq.18.

<sup>61</sup> Po aty, fq.24.

- ✓ Përpilimi i logos për grupet e ndërmjetësimit, identifikimi me ngjyra të përzgjedhura, bluzave, kapelave apo shenjave tjera identifikuese për ndërmjetësuesit;
- ✓ Promovimi i ndërmjetësimit përmes fotove; “E drejta ime të jetoj pa dhunë”;
- ✓ Organizimi i aktiviteteve promovuese në Ditën Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve si dhe në Ditën e ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës (26 Shtatori);
- ✓ Tryezë pune me përfaqësuesit e Drejtorive Arsimore të Komunave për promovimin e konceptit: „Për një shkollë miqësore“;
- ✓ Hartimi i planit të veprimit të shkollës për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve;
- ✓ Krijimi i Klubeve/Ekipeve të Ndërmjetësimit brenda secilës shkollë;
- ✓ Krijimi një hapësire brenda shkollës që është e dedikuar për ndërmjetësim në mes bashkëmoshatarëve;
- ✓ Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i Klubeve/Ekipeve të Ndërmjetësimit;
- ✓ Çmimi për ndërmjetësimin me të mirë në shkollë, në komunë dhe Kosovë .<sup>62</sup>

---

<sup>62</sup> Shih, Doracak i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konflikteve mes Bashkëmoshatarëve në Shkollë, Prishtinë, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe ForumZFD. Maj 2019, Shih Praktikave të mira të realizuara në shkollë dhe të përkrahura nga OJQ-të, fq. 27-55.

Shtojca 1: Dhjetë (10) parimet në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet Bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor

1. **Interesi më i mirë i fëmijës-** Të gjitha aktivitetet dhe veprimet e ndërmarra në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, duhet të jenë në interesin më të mirë të nxënësve;
2. **Vullneti i lirë** - Procesi i ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor zhvillohet me vullnetin e lirë të nxënësëve, i shprehur gojarisht apo me shkrim;
3. **Paanshmëria dhe pavarësia** - Ndërmjetësuesi gjatë zhvillimit të procesit të ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor duhet të mbetet plotësisht i pavarur dhe i paanshëm, në të kundërtën duhet të refuzoj ndërmjetësimin, të njoftojnë nxënësit se nuk është në gjendje që të vazhdojë ndërmjetësimin dhe tërhiqet nga rasti përkatës;
4. **Barazia** - Në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor, palët janë të barabarta dhe të gjithë nxënësit, duhet të trajtohen në të gjitha fazat në mënyrë të barabartë;
5. **Privatësia dhe konfidencialiteti** - Procesi i ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor është i natyrës konfidenciale. Ndërmjetësuesit dhe nxënësit nuk ju lejohet t'i përdorin informacionet të cilat i mësojnë gjatë procesit të ndërmjetësimit;
6. **E drejta e nxënësve për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet** - Gjatë procesit të ndërmjetësimit, nxënësëve u garantohet e drejta për t'i shprehur lirisht pikëpamjet dhe shqetësimet, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij;
7. **E drejta e nxënësit për t'u trajtuar me dinjitet dhe ndjeshmëri** -Dinjiteti individual, nevojat e veçanta, interesat dhe jeta private e nxënësit duhet të respektohen dhe të mbrohen, në të gjitha fazat e procesit të ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor;
8. **Propozimi i mundësisë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, por jo edhe vet zgjidhjen** - Roli kryesor i ndërmjetësuesit në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor është që të lehtësojë zgjidhjen e konfliktit dhe mund të propozojë mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, por jo edhe vet zgjidhjen;
9. **Integriteti** - Ndërmjetësuesi duhet të silllet në mënyrë të ndershme, të dinjitetshme dhe të ketë integritet të lartë moral;
10. **Konflikti i interesit** - Ndërmjetësuesi duhet t'i shmangët konfliktit të interesit gjatë gjithë procesit të ndërmjetësimit.

Shtojca 2: Deklarata nën betim e ndërmjetësuesit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor

Shkolla	
Komuna:	
<b>Deklarata nën betim</b> e <b>ndërmjetësuesit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor</b>	

Unë, \_\_\_\_\_, deklaroj nën betim, se do t'i kryej detyrat e mia të ndërmjetësuesit dhe njëherit do të ruaj konfidencialitetin e punës së ndërmjetësuesit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor.

Veç kësaj,

Unë deklaroj që kam lexuar dhe kuptuar Udhëzuesin për ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor dhe do ta zbatojë gjatë procesit të punës së ndërmjetësuesit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor se bashku me dhjetë (10) parimet në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në kontekstin shkollor.

Emri dhe Mbiemri:	Nënshkrimi:

Vendi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.20\_\_.

Shtojca 3: Forma standarde e raportit të ndërmjetësimit

<b>Shkolla</b>	
<b>Komuna:</b>	
<b>RAPORT PËR PROCESIN E NDËRMJETËSIMIT NDËRMJET BASHKËMOSHATARËVE NË KONTEKSTIN SHKOLLOR</b>	
<b>Për:</b>	Drejtorin e IAP
<b>Ndërmjetësuesi/ët:</b>	(Shëno emrin dhe mbiemrin dhe nënshkrimi)
<b>Data/at e ndërmjetësimit:</b>	
<b>Nxënësit e përfshirë në konflikt:</b>	(Shëno emrat dhe mbiemrat dhe klasët)
<b>Përshkrim i shkurtër për çfarë ishte konflikti</b>	
<b>Si përfundojë ndërmjetësimi:</b> (Të plotësohet njëra nga mënyrat e mëposhtme me "X")	
<b>Është arritur marrëveshja</b>	
<b>Është ndërprerë ndërmjetësimi</b> (Në këtë rast tek rubrika "Përshkrim i shkurtër për çfarë ishte konflikti", përshkruaj shkurtimisht arsyet e ndërprerjes)	
<b>Nuk është arritur marrëveshja</b>	
<b>Marrëveshja e bashkangjitur:</b>	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
<b>Data e dërgimit të raportit:</b>	

Shtojca 4: Forma e Marrëveshjes e arritur në ndërmjetësim ndërmjet bashkëmohatarëve në kontekstin shkollor

<b>Shkolla</b>		
<b>Komuna:</b>		
<b>MARRËVESHJE E ARRITUR NË NDËRMJETËSIM NDËRMJET BASHKËMOSHATARËVE NË KONTEKSTIN SHKOLLOR</b>		
<b>Nxënësi "A"</b> Emri/mbiemri: Klasa:		<b>Nxënësi "B"</b> Emri/mbiemri: Klasa:
<b>U arrit marrëveshje si në vijim:</b>		
<i>(Përdorni fletë shtesë nëse keni nevojë)</i>		
<i>Shembull: Takimi i Ndërmjetësimi filloi më datën __. __. ____ në ora --:-- min. në prezencën e nxënësve të lartshënuar dhe ndërmjetësuesit.</i>		
<i>Fillimisht ndërmjetësuesi i njoftojë nxënësit me parimet e ndërmjetësimi më pas filloi procesi i ndërmjetësimi.</i>		
<i>Në fillim e mori fjalën pala e dëmtuar NNNNN, i cili përshkroi ngjarjen e ndodhur.</i>		
<i>Më pas e mori fjalën pala NNNN, i cili përshkroi ngjarjen e ndodhur</i>		
<i>Më pas arritën marrëveshjen si në vijim:</i>		
.....		
<i>Marrëveshja në këtë seancë të Ndërmjetësimi është arritur me vullnet të lirë dhe të plotë të të gjithë nxënësve pa kurrfarë presioni, dhunë, mashtrimi apo kërcënimi dhe se nuk i kontestojnë asnjërën nga pikat e kësaj marrëveshje.</i>		
<i>Palët e konsiderojnë të mbyllur këtë rast në procedurë të Ndërmjetësimi.</i>		
Nënshkrimi i palëve dhe përfaqësuesve të tyre:		
<b>Nxënësi "A"</b>		<b>Nxënësi "B"</b>
<b>Ndërmjetësuesi</b>	_____	(Nënshkrimi)

## LISTA E BURIMEVE

1. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës;*
2. *Konventa për të drejtat e fëmijës, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989;*
3. *Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (Gazeta Zyrtare, Nr. 14, 20 gusht 2018);*
4. *Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës (Gazeta Zyrtare, Nr. 14, 17 korrik 2019);*
5. *Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 17, 16 shtator 2011);*
6. *Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur (Gazeta Zyrtare, Nr. 17, 18 tetor 2018);*
7. *Rregullore (QRK) Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar;*
8. *Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale;*
9. *Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative;*
10. *Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 05/2021 për Përcaktimin e Procedurës së Ndërmjetësimit të Vetë-inicimit të Rasteve dhe Rasteve të Referuara nga Organi Administrativ;*
11. *Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 04 /2021 për Tarifën e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës;*
12. *Kodi (MD) Nr. 12/2019 i Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës;*
13. *Udhëzim administrativ (MD) Nr. 03/2019 për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës;*
14. *Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave;*
15. *Rregullore Nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Rasteve nga Prokuroria;*
16. *Besim M. Kajtazi: Përmbledhje legjislacioni për ndërmjetësimin në Republikën e Kosovës. Shkrola, Prishtinë, Prill 2022;*
17. *Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar Tetor, 2015;*
18. *Doracak i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konfliktëve mes Bashkëmohatarëve në Shkolla, Prishtinë, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe ForumZFD, Maj 2019;*
19. *Doracak - Ndërmjetësimi në Kosovë - Proceset dhe shkathhtësitë, Partners-Kosova Center for Conflict Management, Laina Reynolds Levy, PhD, Partners for Democratic Change, Mars, 2011;*
20. *Hajrullah Mustafa: Ndërmjetësimi në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe efektshmëria pozitive e tij, Opinio Juris, Nr. 1/2015;*
21. *Manual trajnimi: Ligji për Ndërmjetësimin - USAID Prill 2012.*